

# Rishikim i funksioneve të agjencive

Propozime mbi mënyrën e funksionimit dhe raportimit të agjencive që raportojnë në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Korrik 2018



**DEMOCRACYPLUS**



# Rishikim i funksioneve të agjencive

Propozime mbi mënyrën e funksionimit dhe raportimit të agjencive që raportojnë në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Korrik 2018



**DEMOCRACY PLUS**

Përgatitur nga: **Visar Rushiti**

E drejta e autorit © 2018. Democracy Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Ky publikim është përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Qëndrimet e shprehura këtu jo domosdoshmërisht paraqesin edhe ato të KFOS.



**DEMOCRACYPLUS**

Përkrahur nga:



# Përmbajtja

Përmbledhje	6
Definimi i problemit	10
Korniza e hulumtimit dhe metodologjia	11
Pasqyrë/përmbledhje e funksioneve, raportimit dhe zgjedhjes së bordit të shtatë agjencive sipas legjislacionit aktual	12
<b>AAC - Autoriteti i Aviacionit Civil</b>	<b>13</b>
<b>AKK - Autoriteti Kosovar i Konkurrencës</b>	<b>15</b>
<b>AKP - Agjencia Kosovare e Privatizimit</b>	<b>17</b>
<b>ARKEP - Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare</b>	<b>19</b>
<b>ARH - Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave</b>	<b>20</b>
<b>KPMM - Komisioni i Pavaur për Miniera dhe Minerale</b>	<b>22</b>
<b>ZRRE - Zyra e Rregullatorit të Energjisë</b>	<b>24</b>
Obligimet që dalin nga procesi i integritimit evropian sa i përket politikave dhe kornizës institucionale në fushat që mbulojnë të shtatë agjencitë	25
<b>Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së</b>	<b>26</b>
<b>Udhëzuesi i Komisionit Evropian mbi strukturat kryesore administrative që kërkohen të ketë një vend për implementimin e Acquis – me fokus në shtatë agjencitë</b>	<b>27</b>
Analizë e praktikave të vendeve të rajonit mbi funksionimin dhe raportimin e shtatë agjencive	30
<b>Shqipëria</b>	<b>30</b>
<b>Mali i Zi</b>	<b>33</b>
<b>Kroacia</b>	<b>34</b>
Parimet e OBEZH-it për qeverisjen e rregullatorëve	36
<b>Rregullatorët shumë-sektorësh: rasti i Holandës</b>	<b>36</b>
Përfundime dhe rekomandime	37
Shtojcë	39

# Përmbledhje

Të gjeturat kryesore sipas renditjes së agjencive që janë trajtuar në këtë punim janë:

## AAC

### Autoriteti i Aviacionit Civil:

AAC ka shumicën e funksioneve që mund të klasifikohen si ekzekutive/administrative, ka target primar për raportim Ministrinë e Infrastrukturës dhe Qeverinë derisa bordi dhe drejtori i përgjithshëm zgjedhen dhe shkarkohen nga Ministria dhe Qeveria. Në këtë kuadër, AAC duhet të jetë agjenci në kuadër të Qeverisë;

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) dhe Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) nuk përmendin pavarësinë e AAC-së dhe me këtë rast nevojën e funksionimit dhe raportimit të saj në Kuvend të Kosovës. Në marrëveshjen për themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA), termi gjenerik për të gjitha vendet nënshkruese të marrëveshjes është "autoritet kompetent" i aviacionit civil;

Udhëzuesi i Komisionit Evropian mbi strukturat që duhet të ketë një vend për implementimin e EU acquis, kur i referohet strukturës për aviacion civil, thekson që struktura në fjalë mund të jetë brenda ose e ndarë nga Ministria e Infrastrukturës, por nuk thekson nevojën për një pavarësi në kuptimin organizativ që mund të arsyetoj ndarjen e AAC-së nga ekzekutivi;

Autoriteti i Aviacionit Civil në Shqipëri funksionon nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me status të një institucioni varësie dhe i përgjigjet Ministrisë. Po ashtu, Agjencia e Aviacionit Civil në Mal të Zi funksionon nën Qeveri, përkatësisht nën Ministrinë e Transportit dhe Çështjeve Detare. Në Kroaci, Agjencia e Aviacionit Civil është agjenci qeveritare, përkatësisht nën Ministrinë për Çështje Detare, Trafikut dhe Infrastrukturës. Në asnjërin prej rasteve në të tri vendet në ligjet e themelimit të tyre nuk përmendet raportimi i tyre edhe në Kuvend;

## AKK

### Autoriteti Kosovar i Konkurrencës:

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka funksione rregullatore dhe rol të madh në mbrojtjen e konkurrencës mirëpo pavarësia e tij funksionale dhe organizative nuk është e plotë;

Në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës është hequr fjala "konkurs publik" dhe tani anëtarët e komisionit për mbrojtjen e konkurrencës nuk zgjedhen përmes konkursit të hapur por vetëm propozohen nga Qeveria dhe emërohen në Kuvend. Kjo krijon më shumë hapësirë për Qeverinë për të ndikuar procesin e zgjedhjes së anëtarëve dhe realisht me këtë të dëmtohet pavarësia e tij nga ekzekutivi;

MSA/PKZMSA dhe Udhëzuesi i Komisionit Evropian theksojnë nevojën që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës të ketë një pavarësi funksionale, d.m.th pavarësi edhe në vendimmarrje. Fakti që Qeveria propozon anëtarët e komisionit për emërim në Kuvend, është në kundërshtim me thirrjen për fuqizimin e pavarësisë së këtij autoriteti. Shembull i mirë i propozimit të kandidatëve për emërim (dhe që pas emërimit mund të garantojnë pavarësi në vendimmarrje) nga Kuvendi për anëtar të komisionit të konkurrencës është ai i Shqipërisë: anëtarët propozohen në këtë mënyrë: një nga Presidenti, dy nga Këshilli i Ministrave dhe dy nga Kuvendi;

Autoriteti i Konkurrencës është i pavarur dhe me raportim në Kuvend edhe tri vendet tjera: Shqipëri, Mal të Zi dhe Kroaci;

## AKP

### Agjencia Kosovare e Privatizimit:

Funksionet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit nuk përkojnë me funksionimin dhe raportimin në Kuvend të Kosovës. MSA dhe PKZMSA nuk kanë ndonjë referencë sa i përket mënyrës së funksionimit dhe raportimit të agjencisë. Udhëzuesi i Komisionit Evropian e përmend faktin e ekzistimit të një agjencie për privatizim në nivel qendror por nuk përcakton pavarësinë e saj në kuptimin që duhet të jetë e ndarë nga ekzekutivi. Në këtë udhëzues, agjencia është e përmendur nën kapitullin e politikave industriale dhe të ndërmarrësisë;

Funksioni i privatizimit në Shqipëri ushtrohet nga Drejtoria për Drejtimin e Pronës Publike në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Drejtoria është e barabartë në nivel me departamentin në Kosovë. Në Shqipëri, Agjencia Kombëtare e Privatizimit ka ekzistuar deri në vitin 2006 e cila është shkruarë në këtë vit në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitje së Pronës Publike e cila në vitin 2013 është transformuar në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike.

Funksioni i privatizimit në Mal të Zi ushtrohet nga Këshilli për Privatizim dhe Projekte Kapitale i cili është institucion qeveritar, mandati i tij buron nga Ligji për privatizimin dhe drejtohet nga Kryeministri. Anëtarë tjerë janë një numër i ministrave dhe institucione relevantë në fushën e ekonomisë. Këshilli harton plane vjetore për privatizim të cilat miratohen në Qeveri;

## **ARKEP**

### **Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare:**

Funksionet e Autoritetit janë tipike rregullatore dhe duhet të sigurohet pavarësia e tij nga ekzekutivi. Në anën tjetër, fakti që Ministri i rekomandon anëtarët e bordit dhe Qeveria i propozon për emërim në Kuvend, pa pasur ndonjë konkurs publik paraprak, krijon mundësi të madhe për ndikim në zgjedhjen e anëtarëve të caktuar për anëtar të bordit dhe më pas vënë në pikëpyetje pavarësinë e institucionit nga ekzekutivi;

MSA / PKZMA dhe Udhëzuesi i Komisionit Evropian njohin rëndësinë e funksionimit të pavarur të autoriteteve rregullatore në këtë sektor dhe ngritjen e kapaciteteve që autoritetet rregullatore vendore të mund të bashkëpunojnë me Trupën e Rregullatorëve Evropian për Komunikime Elektronike;

Autoritetet Rregullative për Komunikime Elektronike dhe Postare funksionojnë të pavarur nga ekzekutivi dhe raportojnë në Kuvend edhe në rastin e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kroacisë. Në rastin e Kroacisë, Autoriteti për Komunikime Elektronike dhe Autoriteti i Hekurudhave janë shkriër në një institucion, përkatësisht në Autoritetin Rregullator për Industrinë e Rrjetizimit;

## **KPMM**

### **Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale:**

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka funksione që klasifikohen si administrative dhe të ofrimit të shërbimeve pasi roli kryesor i tij është dhënia e lejeve dhe licencave për shfrytëzimin e resurseve minerale në Kosovë. Në anën tjetër, politikat siç janë Ligji për miniera dhe minerale dhe Strategjia për miniera hartohen nga MZHE, departamenti i minierave. Në bazë të kësaj, nuk ka arsye që Komisioni të raportojë në Kuvendin e Kosovës;

MSA / PKZMSA dhe Udhëzuesi i Komisionit Evropian nuk përmendin në ndonjë pikë mënyrën e funksionimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Në Shqipëri, funksionet e ngjashme me KPMM ushtrohen nga Drejtoria për Miniera në kuadër të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Njerëzore në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Funksioni i njëjtë në Mal të Zi ushtrohet nga "autoriteti kompetent" që në bazë të Ligjit për miniera është i organizuar në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe natyrisht nuk ka ve vetvete vija të llogaridhënies me Kuvendin. Në rastin e Kroacisë, po ashtu departamenti i minierave në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, Ndërmarrësisë dhe Punës është struktura kompetente të cilës i është dhënë ky mandat me Ligjin për minierat;



## ARH

### Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave :

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit zgjedhet sipas rregullave të Ligjit për shërbimin civil, është shërbyes civil, dhe të njëjtën kohë është anëtar i pestë i bordit të Autoritetit. Kjo praktikë nuk është hasur në ndonjë vend tjetër dhe as me bordet e agjencive tjera në Kosovë;

Meqenëse infrastruktura hekurudhore dhe shërbimi i transportit në Kosovë menaxhohen nga kompani publike (Infrakos dhe Trainkos) të cilat marrin para publike nga shteti dhe që të dyja, hekurudha dhe trenat janë pasuri shtetërore, funksioni rregullativ i Autoritetit të Hekurudhave është i diskutueshëm. Funksioni rregullativ në këtë rast hyn në funksion kur një kompani private qoftë në infrastrukturën hekurudhore qoftë në atë të transportit konkuron me ato publiket;

MSA dhe PKZMSA nuk kanë ndonjë Nen apo dispozitë ku përmendin mënyrën e funksionimit të Autoritetit dhe nevojës që të jetë nën Kuvendin dhe i pavarur nga ekzekutivi. Udhëzuesi i Komisionit Evropian përmend vetëm faktin që Autoritete të tilla duhet të jenë të ndara nga ofruesit e shërbimeve hekurudhore dhe të transportit. Për mënyrën e funksionimit të Autoriteti të Hekurudhave në Shqipëri ka pak të dhëna edhe pse Kodi hekurudhor i miratuar në 2012 përcakton funksionimin e Autoritetit në fjalë. Në Mal të Zi, funksioni i rregullatorit dhe menaxhimit të hekurudhave funksionon në formën e Drejtorisë së Hekurudhave në kuadër të Ministrisë së Transportit dhe Çështjeve Detare. Në Kroaci, Autoriteti i Hekurudhave dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike janë bashkuar për të krijuar një institucion të vetëm, Autoritetin Rregullativ për Industrinë e Rrjetizimit;

## ZRRE

### Zyra e Rregullatorit të Energjisë:

Funksionet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë janë rregullatore dhe duke u bazuar edhe në praktikat e vendeve tjera, ky institucion duhet të mbahet i pavarur nga ekzekutivi dhe me pavarësi të plotë sidomos në vendimmarrje;

Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të bordit përmes konkursit është pozitive sidomos duke pasur parasysh që me ligjin paraprak, procedura e zgjedhjes ka qenë vetëm me propozim dhe pa konkurs. Megjithatë, fakti që procedura e zgjedhjes zhvillohet brenda Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe nuk dihet se kush e përbën komisionin vlerësues, është çështje që duhet të adresohet;

Mënyra e zgjedhjes së bordit në Entin Rregullativ të Energjisë në Shqipëri siguron pavarësi më të madhe në përzgjedhje sidomos në krahasim me atë të zhvilluar në Kosovë. Në Shqipëri, bordi prej pesë anëtarëve zgjedhet prej një Ekupi Përzgjedhës i përbërë nga tre persona: Kryetari i Komisionit për Ekonomi dhe Financa, Kryetari i Komisionit që mbulon fushën e energjisë dhe Ministri i cili në kuadër të portfolios ka edhe fushën e energjisë;


Rregullatori i Energjisë është i pavarur dhe me linja të raportimit në Parlament edhe në tri vendet tjera të trajtuara në këtë punim: Shqipëri, Mali i Zi dhe Kroaci;


# Definimi i problemit

Problemi i trajtuar në punim është pjesë e një problemi më të gjërë e që është numri i madh i agjencive të pavarura që raportojnë në Kuvendin e Kosovës. Sipas raportit për vendin të Komisionit Evropian për vitin 2018, Kuvendi nuk ka fuqinë dhe as kapacitetet për të mbikëqyrur në mënyrë efektive 32 agjencitë e pavarura të cila raportojnë në Kuvend. Po ashtu, raporti në fjalë thekson nevojën e kalimit të linjave të llogaridhënies të disa agjencive nga Kuvendi në Qeveri me qëllim që të arrihet një eficiencë më e madhe, vija më të mira të llogaridhënies dhe në fund mbikëqyrje më e mirë e Kuvendit ndaj Qeverisë.

Punimi trajton shtatë agjenci të cilat raportojnë në Kuvendin e Kosovës përmes Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe ideja e punimit ka ardh pikërisht nga komisioni në fjalë. Sipas kërkesës së komisionit, problemi i trajtuar në punim ndahet në dy elemente: e para, a ka nevojë të ekzistojnë këto shtatë agjenci dhe e dyta, a duhet të raportojnë ato në Kuvendin e Kosovës? Problemi tashmë i krijuar është se nga paslufta janë krijuar agjenci të ndryshme në kuadër të Kuvendit të Kosovës dhe që pak nga ato lidhen me funksionet e Kuvendit të Kosovës apo që i ndihmojnë Kuvendit në ushtrimin e funksioneve të tij. Deri me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, agjencitë e tilla janë themeluar me Rregullore të UNMIK-ut e pastaj të njëjtat vetëm janë plotësuar me ligje të miratuara në Kuvend, por asnjëherë nuk është menduar nevoja e ekzistimit të tyre. Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, duke u bazuar në Nenin 142 të Kushtetutës mbi agjencitë e pavarura, janë krijuar edhe një numër i agjencive të tilla të pavarura nën Kuvendin e Kosovës dhe të ndara nga ekzekutivi.

Termi agjenci kryesisht nënkupton një strukturë/njësi organizative e cila krijohet me qëllim të zbatimit të politikave apo të një programi dhe është e natyrës ekzekutive. Si të tilla, këto agjenci krijohen nën Qeveri si pjesë e ministrive të linjës dhe në bazë të Ligjit për administratën shtetërore, njihen si organe qendrore të administratës shtetërore. Departamenti ka rolin e hartuesit të politikave derisa agjencia ka rolin e zbatuesit të tyre. Vetëm në këtë relacion ka kuptim ekzistimi i agjencive. Po ashtu, agjencitë në shumë raste kanë mandat të përkohshëm, themelohen për zbatim të një politike/programi për një kohë të caktuar, me buxhet të caktuar dhe që pas një kohe shuhen. Ndryshe nga kjo, realiteti i agjencive në Kosovë nuk njih agjenci të cilat kanë pasur mandat të përkohshëm dhe që pas kryerjes së mandatit janë shuajtur.





## Korniza e hulumtimit dhe metodologjia

Punimi është hartuar duke marr për bazë disa faktorë: e para, cilat janë funksionet e agjencive dhe sa lidhen ato me funksionet që ka Kuvendi i Kosovës, funksionin legjislativ, mbikëqyrës dhe funksioni përfaqësues. Funksionet e agjencive janë analizuar kundrejt këtyre funksioneve të Kuvendit, si zgjedhen bordet e tyre dhe cila është mënyra e raportimit të tyre në Kuvend. E dyta, është analizuar Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) dhe Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA (2017-2021) për të parë nëse këto dokumente kanë ndonjë kërkesë/obligim sa i përket mënyrë së funksionimit dhe organizimit (pavarësisë) së këtyre agjencive. Pas këtij elementi dhe në funksion të ekzistimit të strukturave për zbatimin e EU acquis, punimi ka analizuar edhe Udhëzuesin e Komisionit Evropian mbi strukturat kryesore administrative që duhet të ketë një vend për zbatimin e EU acquis.

Për të plotësuar ciklin e hulumtimit, punimi ka trajtuar edhe dy aspekte: modelet e funksionimit të këtyre agjencive në tri vende regjionale: Shqipëri, Mali i Zi dhe Kroaci dhe cilat janë parimet e Organizatës për Bashkëpunim Evropian dhe Zhvillim (OBEZH) sa i përket funksionimit të rregullatorëve. Të gjeturat në tri vendet e regjionit kanë konfirmuar se disa agjenci në grupin prej shtatë agjencive, sidomos ato që nuk kanë funksione rregullatore dhe që nuk ka nevojë të sigurohet një pavarësi e tyre nga ekzekutivi, duhet të jenë pjesë e ekzekutivit sepse funksionet që kanë ato janë të natyrës ekzekutive/administrative. Parimet e OBEZH-it janë analizuar vetëm për rregullatorë pasi tri nga shtatë agjencitë në këtë punim janë agjenci rregullatore. Ajo cka promovojnë këto parime është që edhe pse rregullatore, nuk është e domosdoshme që agjencia rregullatore të jetë nën Kuvendin e Kosovës për t'i siguruar pavarësi.

# **Pasqyrë/përmbledhje e funksioneve, raportimit dhe zgjedhjes së bordit të shtatë agjencive sipas legjislacionit aktual**

Kjo pjesë ofron një pasqyrë të tri elementeve për secilën agjenci: funksionet, zgjedhja e bordit dhe raportimi. Pas të tri elementëve, ofrohet një pjesë e diskutimit/analizës që kryesisht do të analizojë funksionet e agjencive nëse ato funksione janë rregullatore dhe që mund të arsyetojnë funksionimin e tyre në kuadër të Kuvendit të Kosovës.


AAC është themeluar në vitin 2008 si agjenci e pavarur me Ligjin për Aviacionin Civil.<sup>1</sup> Ligji ka bazën në Nenin 130 të Kushtetutës në bazë të të cilit AAC rregullon veprimtarinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës dhe është ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror siç është përcaktuar me ligj<sup>2</sup>.

### Funksionet

AAC është një prej katër autoriteteve në fushën e aviacionit civil në Republikën e Kosovës: Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike. Në këtë grup, AAC është përgjegjës për 1) zbatimin e politikave dhe legjislacionit të miratuar nga Ministria apo Qeveria, 2) ofrimin e këshillave për Ministrin, Qeverinë, Kuvendin lidhur me këto politika dhe për propozime të politikave, 3) nxjerrjen e rregulloreve për zbatimin e urdhërave të navigimit ajror në përputhje me ligjin për aviacionin civil, 4) lëshimin e licencave, çerfitikatave dhe lejeve në këtë aspekt, 5) rregullimin e sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës dhe rregullimin e ekonomisë së aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror, 6) mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit përkatës, të rregullave, standardeve dhe 7) kryen hetime dhe inspektime dhe nxjerrë urdhëra dhe rregulla për zbatim të legjislacionit përkatës.

### Zgjedhja e Bordit

Menaxhimi i përgjithshëm i AAC-së është i ndarë në mes të Bordit dhe Drejtorit të Përgjithshëm. Bordi është mbikëqyrës, anëtarët e bordit nuk punojnë me orar të plotë, t vakohen një herë në tre muaj dhe mbikëqyrë AAC-në ushtrimin e të gjitha funksioneve (administrative, ekzekutive, rregullative dhe të licencimit). Bordi përbëhet prej pesë anëtarëve të cilët emërohen nga Qeveria pas pranimit të këshillave dhe propozimeve nga Ministri. Kjo do të thotë që procedura e zgjedhjes dhe emërimit të bordit zhvillohet nga Qeveria. Në anën tjetër, kandidaturat për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm përzgjedhen nga Ministri përkatës (Ministri i Infrastrukturës) dhe i propozon Qeverisë një listë të ngushtë me emra si kandidatë të mundshëm për Drejtor dhe së bashku me CV-të e kandidatëve, Ministri i dorëzon Qeverisë edhe rekomandimin për secilin kandidat. Pas kësaj, Qeveria emëron njërin nga kandidatët për Drejtor të Përgjithshëm të AAC-së. Drejtori ka orar të plotë, ka mandat pesë vjeçar dhe është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm dhe vendimmarrjen në AAC.



1 Ligji nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil: <https://bit.ly/1qBfUSO>

2 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 130: <https://bit.ly/1pdOSYZ>

## Raportimi

Për dallim nga praktikat e shumë agjencive tjera ku bordi (kryetari i bordit) raporton në Kuvend, në rastin e AAC-së është Drejtori i Përgjithshëm ai i cili deri në fund të marsit të çdo viti kalendarik, përgatitë një raport gjithpërfshirës vjetor për Bordin, Ministrinë, Qeverinë dhe Kuvendin. Po ashtu, në bazë të Nenit 26 të ligjit në fjalë, Drejtori i Përgjithshëm përgjigjet para Kuvendit të Kosovës lidhur me përputhshmërinë e AAC-së me politikat e aviacionit civil si dhe të gjitha ligjet dhe standardet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Në praktikë, AAC raporton në Kuvend përmes Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

## Pjesa e diskutimit/analizës

Funksionet e AAC-së nga 1 deri në 5 janë funksione të cilat mund të ushtrohen nga cilado agjenci pavarësisht nëse agjencia është në kuadër të Qeverisë apo Kuvendit. Kjo sepse AAC zbaton politika (funksioni 1) derisa Ministria i harton ato<sup>3</sup> dhe kjo është në përputhje me raportin ministri – agjenci, ku ministria bën politikat dhe agjencia i zbaton ato. Funksioni 2 është funksioni i ofrimit të shërbimit (këshillave) për akterët relevant dhe po ashtu ky funksion nuk do të thotë që duhet patjetër të jetë i një agjencie të pavarur nën Kuvend. Funksioni 3 është funksion që ndahet me Ministrinë e Infrastrukturës por që këtu AAC nxjerrë rregullore në kuptimin e zbatimit të legjislationit, dmth me ligj i është m'veshur ky autoritet. Ofrimi i shërbimeve (lëshimi i certifikatave, lejeve, licencave) është funksion i pastërt administrativ dhe normalisht mund të ushtrohet nga një strukturë (agjenci) ekzekutive/administrative në kuadër të Qeverisë.

Funksioni i vetëm që e bën AAC-në të ketë funksione rregullatore (që në fakt e legjitimon deri diku kërkesën për të qenë jashtë Qeverisë) është funksioni i rregullimit të sigurisë së transportit ajror dhe rregullimin e ekonomisë së aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror. Megjithatë, funksioni rregullator është funksion që hyn në kuadër të funksioneve ekzekutive dhe si i tillë nuk ka arsye pse mos të mund të funksiojë nën degën ekzekutive të Qeverisë. Funksionet 6 dhe 7, mbikëqyrja e legjislationit dhe kryerja e inspektimeve/hetimeve në këtë drejtim, janë po ashtu funksione të cilat mund të ushtrohen nga Kuvendi (sa i përket mbikëqyrjes në zbatimin e legjislationit) dhe Ministria e Infrastrukturës sa i përket inspektimeve dhe marrjes së masave konform inspektimeve. Zakonisht inspektoratet dhe inspektimet janë të organizuara dhe funksionojnë në kuadër të degës ekzekutive.

Sa i përket zgjedhjes së bordit dhe drejtorit të përgjithshëm, vërehet se procesi kryesor në zgjedhjen e tyre është i Ministrisë, përkatësisht Qeverisë dhe nuk kërkohet pëlqimi apo emërimi i tyre në Kuvend. Po ashtu, raportimi i AAC-së ka më shumë në fokus Qeverinë se sa Kuvendin për shkak se Drejtori i Përgjithshëm përgatitë raportin për bordin, ministrinë, Qeverinë dhe Kuvendin. Kjo do të thotë që fokusi është raportimi në Qeveri sepse në fakt është Qeveria (Ministria) e cila e zgjedhë bordin dhe drejtorin e AAC-së dhe raportimi ndaj Kuvendit duket të jetë më shumë formal. Është fakt që drejtori është përgjegjës para Kuvendit për politikat e aviacionit civil (trajtuar më lartë) por fakti që Kuvendi i Kosovës nuk ka ndonjë mekanizëm ndëshkues apo të marrjes së masave në rast të mos performancës së mirë të drejtorit të përgjithshëm, atëherë kjo e bënë raportimin e AAC-së në Kuvend edhe më formal.

3 Ligji nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Neni 6.


Në formën e Komisionit Kosovar të Konkurrencës është themeluar në vitin 2004 me Ligjin për Konkurrencën<sup>4</sup> por në vitin 2010 është miratuar Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe institucioni njihet me emrin Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ku Komisioni është struktura vendimmarrëse e tij<sup>5</sup>. AKK ka për qëllim mbrojtjen e konkurrencës në pajtim me parimet e përgjithshme mbi marrëdhëniet ekonomike sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.<sup>6</sup>

### Funksionet

Përgjegjësitë e AKK-së janë si në vijim: 1) propozon nxjerrjen e akteve nënligjore sipas ligjit përkatës, 2) merr vendime sipas të cilave AKK inicon dhe udhëheq procesin e përcaktimit të ç'rregullimit të konkurrencës, 3) shqipton masa ndëshkuese për shkelje të ligjit dhe përcakton afatet kohore për zbatimin e tyre, 4) përfundon procedurat dhe përcakton masat, kushtet dhe afatet për rivendosjen e konkurrencës efektive të tregut, 5) jep opinione për harmonizimin e projekt-ligjeve dhe akteve tjera nënligjore me këtë ligj, 6) përcakton rregullat për mbrojtjen e konkurrencës në treg dhe 7) promovon njohuritë për konkurrencën në treg dhe me kërkesë të Kuvendit, Qeverisë apo institucione tjera publike qendrore dhe lokale jep mendim profesional në fushën e politikës dhe të drejtës së konkurrencës tregtare.

### Zgjedhja e Bordit

Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës është organi kolegjal vendimmarrës që menaxhon AKK-në, përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, propozohen nga Qeveria dhe emërohen në Kuvend. Mandati i tyre është pesë (5) vjeçar dhe anëtarët mund të emërohen vetëm edhe për një mandat me propozim të Qeverisë. Sipas ligjit bazik për mbrojtjen e konkurrencës, kryetarin dhe anëtarët e tjerë të komisionit i zgjedh Qeveria përmes konkursit të hapur dhe i'a dërgon Kuvendit të Kosovës për emërim<sup>7</sup>, mirëpo sipas plotësim-ndryshimit të ligjit, është hequr fjala "konkurs i hapur". Sipas këtij ligji, Qeveria i'a propozon Kuvendit për emërim ose riemërim kandidatit për anëtar të Komisionit<sup>8</sup>.



4 Ligji nr. 2004/36 për Konkurrencën: <https://bit.ly/1Let9mf>

5 Ligji nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës: <https://bit.ly/1Let9mf>

6 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli IX Marrëdhëniet Ekonomike.

7 Ligji nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës, Neni 25.

8 Ligji nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës, Neni 12: <https://bit.ly/1Let9mf>

## Raportimi

Në emër të institucionit, Komisioni Kosovar i Konkurrencës raporton në Kuvend të Kosovës përmes raportit vjetor për vitin paraprak të cilin e dorëzon në Kuvend më së largu deri më 31 mars të vitit aktual. Në praktikë, Komisioni Kosovar i Konkurrencës raporton në Kuvend përmes Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

## Pjesa e diskutimit/analizës

Me analizimin e këtyre funksioneve nga aspekti se cilat funksione janë rregullatore të cilat duhet të ushtrohen nga një institucion rregullator dhe cilat janë të pastërta ekzekutive/administrative të cilat mund të kryhen nga një ministri apo agjenci ekzekutive, del se AKK ka funksione të cilat patjetër duhet të ushtrohen nga një institucion i pavarur nga Qeveria dhe përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës në treg. Për shembull, funksioni i përcaktimit kur ka ç'rregullime të konkurrencës (funksioni 2) dhe përcaktimi i masave deri në rivendosjen e konkurrencës efektive të tregut (funksionet 3 dhe 4) janë funksione rregullatore me qëllim të ruajtjes së konkurrencës. Pastaj funksionet tjera si: dhënia e opinionit profesional për harmonizim të projektligjeve dhe akteve nënligjore me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës (funksioni 5) dhe përcaktimi i rregullave për mbrojtjen e konkurrencës (funksioni 6), janë po ashtu funksione rregullatore me qëllim të mbrojtjes së konkurrencës së lirë në treg.

Sa i përket zgjedhjes së bordit si organ kolegjal (në këtë rast komisionit), ekziston një balancim në mes të Qeverisë dhe Kuvendit në zgjedhjen e anëtarëve të komisionit por në këtë rast ndikimi i Kuvendit është më i madh se sa në rastin e zgjedhjes së bordit të AAC-së. Megjithatë, është negativ fakti që me plotësim ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës është hequr detyrimi për t'iu nënshtruar konkursit të hapur dhe pastaj kandidatët e suksesshëm të mund të propozohen nga Qeveria për emërim në Kuvend. Derisa në rastin e AAC-së, zgjedhja dhe emërimi i tyre bëhet nga Ministria dhe Qeveria, në rastin e bordit të AKK-së, anëtarët e bordit propozohen nga Qeveria dhe emërohen në Kuvend. Sa i përket raportimit në Kuvend, AKK është përgjegjës vetëm ndaj Kuvendit, dmth nuk ekziston mundësia (të paktën sipas ligjit) që AKK të raportojë në Ministri, Qeveri dhe pastaj në Kuvend, por Kuvendi është instituciononi i parë i përmendur në ligj ndaj të cilit është përgjegjës AKK. Ndryshe nga AAC ku drejtori i përgjithshëm raporton në Komision, në rastin e AKK, bordi përmes raportit vjetor raporton në Kuvend.




AKP është themeluar fillimisht në 2002 në formën e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) përmes Rregullores së UNMIK-ut e pastaj përmes ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2008. Ligji i fundit i cili përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e AKP-së, përbërjen e bordit dhe raportimin është miratuar në vitin 2011 dhe plotësuar ndryshuar në vitin 2012 dhe 2015<sup>9</sup>.

### Funksionet

Funksioni kryesor për të cilin është themeluar dhe vazhdon mandatin AKP është transformimi apo privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore të cilat kanë qenë në pronësi shoqërore para ose pas 22 marsit 1989 me përjashtim të rasteve nëse pas 10 qershorit 1999 është nxjerrë ndonjë rregullore ose ligj i cili është shpallur nga një autoritet kompetent publik në Kosovë dhe përcakton përgjegjësinë për administrimin e asetëve të caktuara te një organ tjetër publik në Kosovë. Në bazë të ligjit aktual në fuqi, AKP ka kompetenca ekskluzive që të administrojë: 1) ndërmarrjet shoqërore pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo, 2) të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekte a jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore me ose pas marsit 22 marsit 1989 dhe 3) të gjitha aksionet në korporata dhe korporatat vartëse të themeluara sipas këtij ligji.

### Zgjedhja e Bordit

Bordi i AKP-së përbëhet prej tetë drejtorëve të cilët propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës, një përfaqësues nga komuniteti jo-shumicë si dhe një përfaqësues nga sindikata e punëtorëve në Kosovë. Po ashtu, me propozim të Qeverisë, Kuvendi cakton edhe kryesuesin e bordit derisa bordi pastaj emëron njërin nga anëtarët e bordit si zëvendëskryesues të bordit. Sipas ligjit, kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe drejtori i sekretarisë ekzekutive të bordit emërohen për një mandat tre vjeçar derisa drejtorët e tjerë emërohen për mandat dy vjeçar. Të gjithë drejtorët kanë të drejtë rizgjedhje dhe nuk përcaktohet nëse edhe një herë apo më shumë.



9 Ligji nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit: <https://bit.ly/2oEKLjb>

## Raportimi

Bordi raporton në baza vjetore përmes raportit vjetor në Kuvend të Kosovës përmes Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

## Pjesa e diskutimit/analizës

Të tri funksionet e listuara të AKP-së kanë një të përbashkët: transformin apo privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore që si funksion në tërësi nuk është që duhet të jetë vetëm nën Kuvend dhe që ky fakt i garanton pavarësinë që duhet të ketë një agjenci e tillë. AKP ka mbetur nën Kuvendin e Kosovës për faktin që ka filluar të ekzistojë në vitin 2002 kur vetëm sa janë krijuar institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë dhe kapaciteti i institucioneve ekzekutive (Qeverisë) ka qenë më i dobët. Për AKP do të duhej të ndjekeshin dy qasje: a) nëse një funksion i tillë do të duhej prap të mbetej nën Kuvendin e Kosovës dhe kjo strukturë të garantojë një pjesëmarrje të balancuar në vendimmarrje në mes të Qeverisë dhe Kuvendit (meqë të tetë drejtorët e bordit propozohen nga Qeveria dhe emërohen në Kuvend), funksionet e AKP mund të bashkohen me funksionet e një agjencie tjetër në Kuvend, b) AKP do të mund të transferohej në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) pasi është ministria me politika të përafërta me ato të AKP-së.

MZHE monitoron performancën e të gjitha ndërmarrjeve publike në nivel qendror në Kosovë përmes Njesisë për monitorimin e ndërmarrjeve publike dhe raporti i njesisë dërgohet në Kuvend, përkatësisht në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Përveq funksionit kryesor të përmendur më lartë, AKP ka edhe një fushëveprim të gjerë të kompetencave në fushën administrative<sup>10</sup> mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet, etj që si kategori e funksioneve administrative bien në fushën e kompetencave ekzekutive të cilat ushtrohen nga dega ekzekutive.

Sa i përket zgjedhjes së bordit, edhe në rastin e AKP-së ekziston një balanc në mes të Qeverisë dhe Kuvendit sepse Qeveria (Kryeministri) i propozon anëtarët dhe Kuvendi i emëron. Mirëpo, nëse marrim parasysh anën praktike se sa ka ndikim Kuvendi në emërimin apo mos emërimin e anëtarëve të propozuar dhe kompetencës në miratimin apo mos miratimin e raportit vjetor të AKP-së, mund të thuhet se më shumë ndikim ka Qeveria se sa Kuvendi. Raportimi bëhet në Kuvend mirëpo ka pasur raste kur raporti i AKP-së nuk është miratuar as në komision as në seancë plenare (në vitin 2015) dhe bordi i njëjtë ka vazhduar mandatin deri në përfundim të tij<sup>11</sup>.

10 Ligji nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Neni 6.

11 Ministria e Administratës Publike (MAP), Rishikimi i Institucioneve dhe Agjencive të Pavarura të Kuvendit dhe Organeve Qendrore të Qeverisë, f. 49, dhjetor 2016: <https://bit.ly/2Dxb2JG>

# ARKEP

## Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

ARKEP në formën aktuale është themeluar në vitin 2012 me Ligjin për Komunikime Elektronike<sup>12</sup> derisa fillimisht është themeluar në vitin 2004 në formën e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit (ART) përmes Ligjit mbi Telekomunikacionin. Sipas Ligjit për Komunikimet Elektronike, ARKEP është pasardhës ligjor i ART-së.

### Funksionet

ARKEP ka një numër të madh të detyrave dhe përgjegjësi të cilat e bëjnë atë të klasifikohet si autoritet rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare në Kosovë. Megjithatë, funksioni rregullator është funksion ekzekutiv dhe si i tillë nuk do të thotë patjetër që të jetë nën Kuvend të Kosovës. Nga lista e gjatë e funksioneve të ARKEP të përcaktuar në ligj, disa prej më kryesoreve janë: 1) bashkë me Ministrinë, përgatitë Planin Kombëtar të Radio-Frekuencave, 2) merr vendime në lidhje me përcaktimin e tregjeve përkatëse, kryen analizat e tregut, 3) merr vendime lidhur me përcaktimin e ofruesve të shërbimeve universale dhe përcaktimin e obligimeve dhe të drejtave të tyre, 4) monitoron dhe rregullon dispozitat e komunikimeve elektronike publike të rrjetave dhe shërbimeve, 5) miraton Planin Kombëtar të Numeracionit, Planin për përdorimin e Radiofrekuencave (kanaleve) dhe planet e zhvillimit të radio komunikimit, 6) merr vendime lidhur me grantet, transferet dhe revokimin e licencave individuale për përdorimin e spektrit të radio frekuencave në bazë të tenderit publik dhe procedurave të ankandit publik, etj.

### Zgjedhja e Bordit

Bordi i ARKEP përbëhet prej pesë anëtarëve të cilët me rekomandim të Ministrit i propozon Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Mandati i anëtarëve është pesë vjeçar me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe një herë. Njëri nga anëtarët është Kryetar i bordit i cili propozohet në këtë pozitë në mesin e anëtarëve të cilët i rekomandon ministri dhe Qeveria i propozon për emërim në Kuvend.

12 Ligji nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike: <https://bit.ly/2EGx3l4>



### Raportimi

ARKEP raporton në Kuvend të Kosovës përmes raportit të cilin e dërgon në Kuvend brenda gjashtë mujorit të parë të vitit aktual. Raportimi në Kuvend bëhet përmes Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

### Pjesa e diskutimit/analizës

Bazuar në funksionet e cekura më lartë, ARKEP ka funksione rregullatore, nevoja e ekzistimit të tij është e qartë edhe pse nevoja nëse duhet patjetër të jetë nën Kuvendin e Kosovës është e diskutueshme. Në anën tjetër, me qëllim të racionalizimit të disa shërbimeve teknike-administrative dhe eficiencës në shpenzimin e buxhetit, mund të konsiderohet bashkimi i dy ose më shumë rregullatorëve me kushtin që kjo mos të ndikojë ushtrimin e funksionit/eve për të cilat janë themeluar rregullatorët. Kjo nënkupton bashkim (fuzionim) sa i përket administratës dhe jo funksionit vendimmarrës të njërit apo tjetrit rregullator.

Sa i përket zgjedhjes së bordit, në këtë rast ekziston një ngjashmëri më e madhe në mes të këtij rasti dhe AAC-së. Edhe pse në rastin e ARKEP, emërimi i anëtarëve të bordit bëhet në Kuvend, Ministri i rekomandon, Qeveria i propozon dhe Kuvendi i emëron. Edhe në këtë rast, Kuvendi vjen në shprehje në kuptimin formal të emërimit të tyre derisa procedura e përzgjedhjes së anëtarëve zhvillohet në mes të Ministrit dhe Qeverisë. Sa i përket raportimit, vetëm koha e dërgimit të raportit në Kuvend dallon nga agjencitë tjera derisa procedura tjetër është e njëjtë. Kryetari i bordit e përfaqëson ARKEP-in dhe është personi i cili raporton në Kuvend të Kosovës.

### Funksionet


ARH ka disa funksione të cilat ushtrohen nga katër departamente të themeluara në kuadër të ARH-së. Në Ligjin për Hekurudhat nuk listohen funksionet që i ushtron ARH por në bazë të ligjit dhe detyrave të departamenteve, mund të nxjerrim një numër të detyrave dhe funksioneve që ka ky institucion. Përmes departamentit të licencimeve, ARH licencion makinistët, ndërmarret hekurudhore të cilat janë të domosdoshme për operimet me shërbimet hekurudhore dhe menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore, bënë suspendimin dhe revokimin e licencave. Përmes departamentit të tregut, ARH sigurohet që pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskrimuese (rregullim i tregut). Menaxher i infrastrukturës hekurudhore është ndërmarrja e cila e menaxhon infrastrukturën hekurudhore e cila është e licencuar për të menaxhuar këtë aset dhe ka autorizimin e sigurisë nga ARH (departamenti i sigurisë) për të ofruar shërbime të sigurta infrastrukture. Në rastin aktual në Kosovë, menaxher i infrastrukturës hekurudhore (shtetërore) është ndërmarrja publike Infracos e cila funksionon mbi baza komerciale dhe ka licencën dhe autorizimin e sigurisë nga ARH. Në anën tjetër, pjesa e dytë e strukturës në tërësi hekurudhore është transporti hekurudhor që prap në rastin e Kosovës ushtrohet nga ndërmarrja tjetër publike Trainkos e cila po ashtu funksionon mbi baza komerciale dhe ka licencën dhe autorizimin e sigurisë nga ARH. Të dy këto ndërmarrje publike rregullohen në tërësi sipas Ligjit për ndërmarrjet publike.<sup>13</sup>

Nëse analizohen këto detyra të ARH-së, mund të thuhet se janë katër funksione kryesore të ARH-së: 1) licencimi i kompanive për menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore dhe kompanive për ofrimin e shërbimeve në këtë infrastrukturë hekurudhore, 2) lëshimi i autorizimeve (lejeve) të sigurisë për këto ndërmarrje të cilat operojnë me infrastrukturën dhe transportin hekurudhor për të ofruar shërbime të sigurta hekurudhore, 3) rregullimi i tregut deri në masën që sigurohet se ndërmarrja e shërbimit të transportit (në këtë rast trainkos) është duke aplikuar çmime ndaj udhëtarëve të cilat nuk janë diskriminuese dhe që janë në linjë me politikat që

përcakton ARH. Funksioni i katërt sipas ligjit, ai i interoperabilitetit, është funksioni që mundëson se sistemi hekurudhor i Kosovës t'i plotësojë kushtet për interoperabilitet (ndër-veprim) me vendet tjera dhe që hekurudhat e Kosovës të jenë pjesë e zonës evropiane hekurudhore.

### Zgjedhja e Bordit

Bordi i ARH-së përbëhet prej katër anëtarëve dhe Drejtorit të Përgjithshëm i cili është anëtari i pestë i bordit. Funksioni i bordit është mbikëqyrës, nuk punon me orar të plotë, ka mandat pesë vjeçar i cili mund të përsëritet vetëm edhe një herë. Katër anëtarë të bordit me rekomandim të Ministrisë së Infrastrukturës propozohen nga Qeveria dhe emërohen në Kuvend. Drejtori i Përgjithshëm shërben si Kryeshef Ekzekutiv i ARH-së i cili edhe pse është anëtar i pestë i bordit, emërohet dhe shkakohet nga Bordi sipas rregullave të shërbimit civil. Njëri prej anëtarëve të bordit zgjedhet edhe si kryesues i bordit.



13 Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike: <https://bit.ly/1vs647w>

## Raportimi

ARH raporton përmes raportit vjetor por edhe sipas kërkesës në Kuvendin e Kosovës në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

### Pjesa e diskutimit/analizës

Problemi që mund të ceket aktualisht me funksionimin dhe në fakt ekzistimin e ARH-së është se të dy, hekurudhat (infrastruktura) dhe trenat (transporti) janë në menaxhim të ndërmarrjeve publike të cilat menaxhohen dhe rregullohen sipas Ligjit për ndërmarrjet publike. Këto ndërmarrje licencohen, autorizohen dhe çmimet e tyre rregullohen nga ARH por nuk ka një konkurrencë në anën tjetër nga kompani private të cilat përveç hekurudhës në pronësi shtetërore, do të vendosnin edhe linja tjera të hekurudhave dhe që pastaj do të përbënin konkurrencë me kompaninë publike Infracos. Po kështu mund të thuhet edhe për shërbimin e transportit (trenat – Trainkos) i cili menaxhohet nga ndërmarrja publike dhe nuk ka një ndërmarrje tjetër private e cila do të kërkonte të licencohet, autorizohet në kuptim të sigurisë nga ARH dhe që çmimet e transportit pastaj të mbikëqyren nga ARH. Kjo do të thotë që ARH tash për tash nuk rregullon treg për shkak të mungesës së konkurrencës edhe pse sigurimi i konkurrencës në treg është detyrë e ARH-së. Për më shumë, sistemi hekurudhor në Kosovë merr para publike edhe pse në ligj thuhet që kjo ndihmë e shtetit nuk duhet t'a ç'rregulloj konkurrencën në sektorin hekurudhor.

Sot për sot, ajo që mund të thuhet është se detyrë e ARH-së është licencimi dhe autorizimi i ndërmarrjeve publike për të operuar (në këtë rast infrakos dhe trainkos) dhe bënë një rregullim të tregut deri në masën sa të kujdeset për çmimet që i vendos ndërmarrja publike, por nuk rregullon tregun hekurudhor në kuptimin në mes të ndërmarrjeve që ofrojnë këto shërbime. Po ashtu, funksioni i interoperabilitetit të hekurudhave të Kosovës me hekurudhat në vendet tjera është një funksion i cili sot nuk është aktual. Sa i përket zgjedhjes së bordit, ekziston një ngashmëri me bordin e AAC-së dhe ARH-së ngase të dy bordet janë vetëm mbikëqyrëse dhe nuk punojnë me orar të plotë. Në anën tjetër, një veçanti në rastin e përbërjes së bordit të ARH-së është përfaqësimi i drejtorit të përgjithshëm të ARH-së si anëtar i pestë i bordit. Në njëren anë thuhet që bordi i ARH përbëhet nga katër anëtar të cilët me rekomandim të Ministrisë propozohen nga Qeveria dhe emërohen në Kuvend, në anën tjetër, drejtori i përgjithshëm është shërbyes civil, shërben si kryeshef ekzekutiv i ARH-së, zgjedhet sipas rregullave të përcaktuara me ligjin për shërbimin civil dhe është anëtar i bordit.

# KPMM

## Komisioni i Pavaur për Miniera dhe Minerale


KPMM është themeluar në vitin 2005 përmes Rregullorës së UNMIK-ut e cila është plotësuar ndryshuar me Ligjin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2008. KPMM funksionon tani në bazë të Ligjit për minierat dhe mineralet të miratuar në vitin 2010<sup>14</sup> por që pjesërisht është i shfuqizuar nga Ligji për shërbimin gjeologjik të Kosovës të miratuar në vitin 2014<sup>15</sup>.

### Funksionet

Në bazë të Ligjit aktual, KPMM ka dy përgjegjësi dhe tri detyra në fushën e resurseve minerale. KPMM është përgjegjës për të siguruar: 1) hulumtimin dhe shfrytëzimin e rregullt të resurseve minerale në Kosovë dhe shfrytëzimin optimal të tyre në të gjitha veprimtaritë minerare sipas ligjit për KPMM dhe strategjisë minerare, 2) përputhjen e veprimtarive minerare me këtë ligj dhe aktet tjera nënligjore dhe me lejet e licencat e lëshuara nga KPMM. Në funksion të këtyre dy përgjegjësive, KPMM ushtron këto kompetenca: a) bën lëshimin, transferimin, vazhdimin, pezullimin dhe revokimin e lejeve dhe licencave, b) themelimin dhe mirëmbajtjen e një kadastrë të minierave dhe një bazë të të dhënave GIS që përmban të dhëna gjeografike, gjeologjike dhe të gjithë titujt ekzistues të mineraleve dhe të të drejtave minerare, dhe c) nxjerrjen e rregullave për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të KPMM-së.

### Zgjedhja e Bordit

Bordi i KPMM-së përbëhet prej pesë anëtarëve të cilët zgjedhen nga Qeveria dhe emërohen në Kuvend. Procedura e zgjedhjes së tyre fillon me hapjen e konkursit nga Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë (zyrës së Kryeministrit) dhe anëtarët në bazë të aplikimit dhe përmbushjes së kriterëve, përzgjedhen nga një komision i themeluar ad-hoc për këtë qëllim me vendim të Qeverisë. Komisioni i zgjedhë nga dy kandidatura për një pozitë dhe i dërgon në Qeveri dhe pastaj Qeveria i dërgon për emërim në Kuvend. Kuvendi duhet të zgjedhë njërin nga dy kandidaturat për një pozitë apo edhe t'i refozojë ato për atë pozitë. Në rastin e fundit, procedura e aplikimit sipas procedurës paraprake përsëritet deri në emërimin e të gjitha pozitave nga Kuvendi i Kosovës. Mandati i anëtarëve nuk është i njëjtë për të gjithë anëtarët fillestar: një anëtar ka mandat katër vjeçar, dy kanë mandat tre vjeçar dhe dy të tjerë kanë mandat dy vjeçar pastaj mandati i pasardhësve të tyre është i njëjtë për të gjithë anëtarët, katër vjeçar. Asnjë anëtarë nuk mund të shërbejë në bord për më shumë se dy mandate.



14 Ligji nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale: <https://bit.ly/1MZv2c>

15 Ligji nr. 04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës: <https://bit.ly/1MZv2c>

## Raportimi

KPMM raporton në Kuvend të Kosovës, përmes Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Sipas ligjit, KPMM brenda 90 ditësh nga përfundimi i vitit kalendarik, i dorëzon Kuvendit një raport vjetor i cili përmban një numër të elementëve të përcaktuara me ligj.

## Pjesa e diskutimit/analizës

Nëse i analizojmë funksionet, del se KPMM nuk bënë politika në fushën e minierave dhe minierave sepse kjo mbulohet nga Ministria për Zhvillim Ekonomik (departamenti i minierave) derisa funksioni i KPMM-së është të lëshoj leje dhe licenca për hulumtim dhe shfrytëzim të këtyre mineraleve sipas ligjit për KPMM dhe strategjisë minerare të cilat janë të hartuara nga MZHE dhe miratuar në Kuvend. Në anën tjetër, KPMM siguron që veprimtaritë minerare janë në përputhje me lejet dhe licencat që paraprakisht i ka lëshuar, dmth këtu hyn edhe funksioni i inspektimit nëse shfrytëzuesit janë duke kryer veprimtaritë e tyre sipas lejeve dhe licencave të lëshuara më parë. E para, lëshon leje edhe licenca sipas ligjit dhe strategjisë minerare dhe e dyta, ku jdeset që operatorët që kanë marrë këto leje edhe licenca janë duke bërë shfrytëzim të rregullt të resurseve minerale sipas lejeve dhe licencave. Funksioni i parë është funksion administrativ (lëshimi i lejeve dhe licencave) dhe funksioni i dytë është funksion inspektimi që e bëjnë edhe një numër i inspektorateve tjera që janë të organizuara në kuadër të ministrive në Kosovë.

Sipas kësaj, nuk ka arsye që KPMM të jetë nën Kuvendin e Kosovës dhe të raportoj në Kuvend. Lidhja në MZHE në mes të departamentit të minierave i cili harton strategji në këtë fushë dhe KPMM-së i cili do të kryente funksionet ekzekutive-administrative (lëshillimi i lejeve dhe licencave dhe inspektimi) është një kombinim i mirë i funksionimit në mes të ministrisë dhe agjencisë (në këtë rast KPMM-së). Për më shumë, meqenëse ekziston një afërsi në fushën e punës (politikave) në mes të KPMM-së dhe SHG-JK-së nën MZHE, do të duhej të shikohej mundësia e integritit të dy trupave, njëri agjenci në kuadër të Kuvendit dhe tjetri agjenci (organ qendror) në kuadër të MZHE-së, që të funksionojnë si një organ i përbashkët nën MZHE.

Sa i përket zgjedhjes së bordit, KPMM dallon nga të gjitha agjencitë e trajtuara deri tani në dy kup-time: 1) aplikimi i konkursit të hapur në zgjedhjen e anëtarëve të bordit të KPMM-së dhe 2) Qeveria zgjedhë nga dy anëtar për secilën pozitë dhe Kuvendi vendos për njërin dhe në rast se nuk voton për njërin prej tyre, procedura kthehet në fillim.

# ZRRE

## Zyra e Rregulatorit të Energjisë

ZRRE është themeluar në vitin 2004 me anë të Ligjit për rregullatorin e energjisë. Aktualisht ZRRE funksionon në bazë të një ligji tjetër, Ligjit për rregullatorin e energjisë të miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2016<sup>16</sup>.

### Funksionet

ZRRE është agjenci rregullatore dhe kjo dëshmohet përmes një numri të detyrave dhe përgjegjësi. Në mes tjerash, ZRRE ka këto detyra dhe përgjegjësi: 1) përkujdeset për funksionim transparent dhe jo-diskriminues të tregjeve të energjisë duke u bazuar në parimet e tregut të lirë, 2) monitoron dhe përmirëson sigurinë e furnizimit me energji elektrike duke përfshirë edhe sigurimin e mirëmbajtjes dhe ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme të gjenerimit, transmetimit e të shpërndarjes, kapacitetin e deponimit dhe kapacitetin e interkoneksionit, 3) të sigurojë se tarifat e rregulluara për aktivitete të energjisë janë të arsyeshme dhe të vendosura në bazë të një metodologjie tarifore të përshtatshme, 4) të sigurojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të licensuarve me rregulla adekuata për zgjidhje të kontesteve, 5) të sigurojë se konsumatorët kanë të drejtë t'i lidhin objektet e veta në sistemet energjetike dhe të pranojnë furnizim të energjisë dhe 6) t'a promovojë tregun e brendshëm konkurrues të energjisë, duke siguruar hapje efektive të tregut për të gjithë konsumatorët dhe furnizuesit, etj.

### Zgjedhja e Bordit

Bordi i ZRRE-së përbëhet nga pesë anëtarë, njëri prej të cilëve zgjidhet kryesues i bordit. Procedura e zgjedhjes së tyre zhvillohet nga Ministria përkatëse për energji, në këtë rast nga MZHE përmes një konkurrimi të hapur. Pas pranimit të aplikacioneve, Qeveria (në këtë rast Ministria) bënë selektimin e nga dy kandidatëve për një pozitë të lirë. Kuvendi emëron njërin nga dy kandidatët e propozuar të Qeverisë për pozitën e lirë të anëtarit të bordit të ZRRE-së. Mandati i anëtarëve të bordit është pesë vjeçar mirëpo koha e përfundimit të mandatit nuk është e njëjtë për secilin anëtar. Anëtarët e bordit mund të zgjedhen edhe për një mandat tjetër pesë vjeçar.

Bordi - 5 Anëtarë



Zgjedhen përmes konkursit.  
Propozohen nga Qeveria

Emërohen nga  
Kuvendi

Mandat 5 Vjeçar

### Raportimi

ZRRE raporton në Kuvend të Kosovës përmes Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Kryesuesi i bordit i raporton Kuvendit përmes raportit vjetor jo më vonë se tre muaj pas mbylljes së vitit kalendarik.

### Pjesa e diskutimit/analizës

Funksionet e ZRRE-së të përcaktuara në ligjin përkatës janë funksione të një rregullatori, në këtë rast të rregullatorit të tregut të energjisë përmes vendosjes së tarifave të energjisë, tregut të lirë, promovimit të konkurrencës në tregun e energjisë, lirisë së konsumatorëve që të lidhen me sistemin e energjisë sipas preferencave të tyre, etj. Edhe në bazë të shumicës së praktikave të vendeve tjera, rregullatori i energjisë funksionon nën Kuvend dhe me këtë mendohet të sigurohet një pavarësi nga ekzekutivi. Sa i përket zgjedhjes së bordit, procedura është e afërt me atë të KPMM-së por që konkursi në rastin e ZRRE-së hapet nga ministria përkatëse për energji (në këtë rast MZHE). Në këtë rast ekziston një lidhje dhe balancim në mes të ndikimit të Ministrisë (Qeverisë) dhe Kuvendit në zgjedhjen e anëtarëve. Derisa Qeveria harton listën e ngushtë të kandidatëve për anëtar të bordit (nga dy persona për secilën pozitë) dhe i propozon për emërim në Kuvend, Kuvendi i ipet mundësia të zgjedhë në mes të dy kandidatëve apo edhe të refuzojë të dy kandidatët dhe procedura të kthehet në fillim. Në këtë aspekt, është me rëndësi të vlerësohet edhe pikëpamja e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për pjesën e pavarësisë së rregullatorit. Sipas kësaj, organizimi, kompetencat dhe pavarësia e ZRRE-s është në përputhje me trupin e ligjeve të BE-së (EU acquis), megjithatë, nga ana praktike thuhet që funksionimi i ZRRE është bllokuar në Prill 2017 për shkak të mungesës së kuorumit dhe rrjedhimisht pamundësisë në vendimmarje<sup>17</sup>.

16 Ligji nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë: <https://bit.ly/2bHUUpZ9>

17 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Përpunueshmëria, Autoriteti rregullator: <https://bit.ly/2wwciKf>



# Obligimet që dalin nga procesi i integritimit evropian sa i përket politikave dhe kornizës institucionale në fushat që mbulojnë të shtatë agjencitë



Fusha të caktuara të politikave dhe korniza institucionale për ato politika, aspektet e funksionimit të institucioneve përkatëse, nuk janë çështje që përcaktohen njëanshmërisht dhe pa përfillur kushtet/kërkesat që dalin nga procesi i integritimit të Kosovës në Bashkimin Evropian (BE). Në këtë kuadër, trupi i ligjeve të BE-së (EU Acquis) ka përcaktuar këto rregulla të cilat për Kosovën në këtë fazë janë përcaktuar kryesisht përmes Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). MSA përfaqëson marrëdhëniet kontraktuale në mes të BE-së dhe Kosovës dhe Kosova duhet të përmbushë të gjitha obligimet që dalin nga MSA gjatë një periudhe dhjetë (10) vjeçare. Për këtë qëllim, nën koordinimin e Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE), institucionet e Kosovës kanë hartuar planin e dytë me radhë për zbatimin e MSA-së.

Megjithatë, në aspektin e strukturave institucionale/administrative që një vend duhet të ketë për implementimin e trupit të ligjeve të BE-së, është hartuar nga ana e Komisionit Evropian edhe një udhëzues i cili përcakton në bazë të politikave që mbulon BE, se cilat janë strukturat administrative që duhet të ketë vendi i caktuar për implementimin e legjislacionit të BE-së. Megjithëse udhëzuesi është hartuar në vitin 2013 dhe nga ajo kohë nuk është përditësuar më, prap se prap paraqet një dokument të mirë udhëzimi se çfarë strukturash administrative duhet të ketë një vend dhe cili duhet të jetë niveli i pavarësisë së tyre për të bërë në mënyrë të duhur zbatimin e legjislacionit të BE-së. Në këtë funksion, kjo pjesë trajton se cilat janë kërkesat eventuale që dalin nga këto dy dokumente në aspektin e funksionimit dhe nivelit të pavarësisë së strukturave institucionale (agjencive) të cilat janë objekt trajtimi në këtë punim. Këto dy dokumente janë: 1) MSA dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, dhe 2) Udhëzuesi mbi strukturat kryesore administrative që kërkohen për zbatimin e legjislacionit të BE-së.

## Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së

MSA është nënshkruar më 27 tetor 2015 në Strasburg në mes të Kosovës dhe BE-së, është miratuar nga Qeveria më 30 tetor<sup>18</sup> derisa është ratifikuar nga Kuvendi më 2 nëntor 2015<sup>19</sup>. MSA ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Për adresimin e kërkesave që dalin nga MSA, në vitin 2016 e më vonë në 2017 është miratuar Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2017-2021 (PKZMSA)<sup>20</sup> dhe Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) e cila ka për qëllim përcaktimin e prioritetëve për përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA<sup>21</sup>. MSA dhe rrjedhimisht PKZMSA përmbajnë disa formulime në formën e kërkesave dhe nganjëherë udhëzimeve sa i përket fushave të politikave që mbulojnë të shtatë agjencitë në fjalë dhe elementët që duhet pasur parasysh për funksionimin institucional të tyre.



Sa i përket Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC), MSA sa i përket transportit ajror në Nenin 60 i referohet kushteve sipas Marrëveshjes për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA). Kosova është nënshkruese e kësaj marrëveshje dhe termi që përdoret në këtë marrëveshje për institucionin/autoritetin që duhet të funksionojë në nivel vendi është "Autoritet Kompetent i Aviacionit Civil"<sup>22</sup> por që nuk thotë nëse autoriteti i tillë duhet të jetë nën Kuvend, i ndarë nga Qeveria, apo ndonjë specifikë tjetër. Sipas termit më lartë i cili i referohet të gjitha vendeve nënshkruese, autoriteti kompetent i aviacionit civil do të thotë një agjenci qeveritare ose entitet i cili ushtron të drejtat ligjore në fushën e aviacionit civil të cilat i janë dhënë përmes ligjit. PKZMSA në pjesën e kornizës së politikave dhe legjislacionit në fushën e aviacionit civil përmend të arriturat në këtë drejtim dhe të njëjtën kohë përmend hapat që duhet ndërmarrë në zbatim të mëtejshëm të direktivave të BE-së dhe fazave tjera sipas marrëveshjes HPEA.

Sa i përket politikave dhe kornizës institucionale në fushën e konkurrencës që janë relevante sa i përket funksionimit të Autoriteti Kosovare të Konkurrencës (AKK), MSA dhe PKZMSA përmendin rëndësinë e mekanizmave për mbrojtjen e konkurrencës dhe përcaktojnë rregulla sa i përket ndihmës shtetërore dhe mekanizmave institucional për të marrë vendime në këtë aspekt. Në kuptim të strukturës (agjencisë) që duhet të ketë vendi për të mbrojtur konkurrencën, MSA në Nenin 75, pika 3 përcakton që duhet të ketë një autoritet që është i pavarur në kuptimin funksional i cili do të ketë autoritetin për të marrë vendime sa i përket kushteve që përcakton në favor të mbrojtjes së konkurrencës. Asnjë dispozitë në këtë kapitull nuk ka specifika tjera sa i përket nëse autoriteti përkatës duhet të jetë nën Kuvend, i ndarë nga Qeveria apo ndonjë elementi tjetër përveç që të sigurohet një pavarësi funksionale e autoritetit i cili është përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës.

Sa i përket politikave në privatizim dhe kornizës institucionale në këtë drejtim, MSA nuk ka ndonjë nen i cili i referohet privatizimit apo Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nëse një mekanizëm i tillë duhet të funksionojë dhe në çfarë forme të funksionojë. PKZMSA në pjesën për privatizimin dhe AKP-në vetëm e tregon një historik të AKP-së dhe ish AKM-së, numrin e ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara deri më tani dhe numrin e tyre që kanë

18 Vendimi nr. 02/55 i datës 30 tetor 2015: <https://bit.ly/2vYt4Be>

19 Ligji nr. 05/L-069 i datës 2 dhjetor 2015: <https://bit.ly/2HYpeNr>

20 Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (2017-2021): <https://bit.ly/2EGDaWt>

21 Agjenda për Reforma Evropiane, nëntor 2016: <https://bit.ly/2t1vOMU> dhe Prioritetet kyqe të Agjendës Evropiane për vitin 2018, Vendimi nr. 01/13 i datës 10 nëntor 2017: <https://bit.ly/2HhLH7O>

22 Marrëveshja për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane (HPEA), tetor 2006: <https://bit.ly/2JGvPt9>

mbetur të privatizohen. Nuk ka ndonjë kërkesë tjetër sa i përket funksionimit të AKP por me vetë faktin e mbetjes edhe të një numri të ndërmarreve shoqërore për t'u shitur (përafërsisht 290), mund të thuhet se AKP do të funksionojë edhe për një kohë. Megjithatë, në çfarë formë do të mund të funksionojë AKP, të vazhdojë funksionimin nën Kuvend, të transferohet nën Qeveri, të i caktohet një mandat deri kur të funksionojë, janë të gjitha çështje që duhet të diskutohen nga institucionet vendimmarëse në Kosovë.

Sa i përket fushës së komunikimeve elektronike dhe me këtë Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), MSA në Nenin 111 përmend faktin e rritjes së pavarësisë së autoriteteve relevante rregullatore në fushën e komunikimeve elektronike por nuk specifikon nëse kjo pavarësi duhet të sigurohet duke qenë nën Kuvend, Qeveri apo tjetër. Sa i përket fushave që mbulojnë Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) dhe Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH), MSA nuk ka ndonjë nen përmes të cilit i referohet ekzisimit ose mënyrës së funksionimit të KPMM-së dhe ARH-së. PKZMA në fushën e energjisë dhe transportit hekurudhor vetëm përmend se cilat janë institucionet kryesore në të dy fushat pa ndonjë kërkesë specifike sa i përket mënyrës së funksionimit të tyre. Sa i përket Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), MSA nuk ka ndonjë dispozitë specifike sa i përket funksionimit të ZRRE-së përveç që bashkëpunimi në fushën e energjisë duhet të funksionojë sipas ekonomisë së tregut dhe Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë. PKZMSA përmend faktin e ruajtjes së pavarësisë së rregullatorit të energjisë si dhe krijimin e mekanizmave transparente për të caktuar çmimet e energjisë.

## Udhëzuesi i Komisionit Evropian mbi strukturat kryesore administrative që kërkohen të ketë një vend për implementimin e Acquis – me fokus në shtatë agjencitë

Një dokument i karakterit udhëzues sa i përket se çfarë strukturash administrative duhet të ketë një vend që do të implementojë trupin e ligjeve të BE-së është Udhëzuesi i Komisionit Evropian mbi strukturat administrative për zbatimin e EU acquis<sup>23</sup>. Ky dokument është konsultuar në këtë pjesë duke u fokusuar në udhëzimet që ka mbi strukturat (agjencitë) të cilat janë objekt trajtimi në këtë punim. Pjesa në vazhdim paraqet këtë trajtim sipas renditjes së agjencive në këtë punim.

Sa i përket transportit ajror dhe strukturave që duhet të ketë një vend në këtë fushë të politikave, që në rastin e këtij punimi lidhet me funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC), udhëzuesi sa i përket mbulimit të funksioneve sa i përket sigurisë, efikasitetit, kapacitetit dhe standardeve të mjedisit, përmend domosdoshmërinë e krijimit të një trupe të aviacionit civil e cila mund të jetë brenda ose e ndarë nga Ministria së Transportit<sup>24</sup>. Përveç detyrave më sipër, kjo strukturë do të duhet të merrej edhe me një varg çështjesh tjera që lidhen me ekonominë e aeroporteve, mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave që i lëshon sipas ligjit, etj. Përveq kësaj strukture, udhëzuesi në fjalë përcakton edhe nevojën e themelimit të një trupi hetues i cili duhet të jetë i pavarur dhe permanent dhe që ka për detyrë hetimin e incidenteve dhe aksidenteve aeronautike. Sa i përket këtij të fundit, në kuadër të zyrës së Kryeministrit funksionon Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike<sup>25</sup> i organizuar në nivel të agjencisë në kuadër të ZKM-së. Megjithatë, funksionet e përmendura më lartë që duhet të i mbulojë një autoritet i një vendi në fushën e aviacionit civil, është pak e paqartë si se ndahen në Kosovë në mes të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe Agjencisë për Shërbimet e Navigimit Ajror<sup>26</sup> në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës.

23 Udhëzuesi i Komisionit Evropian mbi strukturat kryesore administrative që duhet të ketë një vend për implementimin e Acquis, 2013.

24 Udhëzuesi i Komisionit Evropian mbi strukturat kryesore administrative që duhet të ketë një vend për implementimin e Acquis, 2013, f. 61

25 Zyra e Kryeministrit, Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA): <https://bit.ly/2FrNces>

26 Agjencia për Shërbimet e Navigimit Ajror (ASHNA) është themeluar me ligj të veçantë dhe është e organizuar si agjenci në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës. Ligji nr. 04/L-250: <https://bit.ly/2KqG1qO>

Sa i përket politikave të konkurrencës dhe në këtë rast Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK), udhëzuesi në fjalë kërkon që të vendi të ketë një Autoritet Kombëtar të Konkurrencës i cili do të ketë fuqinë të vendos në rastet e mbrojtjes së konkurrencës, të ndërmarrit hetime ndaj veprimeve që e dëmtojnë konkurrencën dhe të ketë të drejtën për të shqiptuar sanksione në favor të ruajtjes së konkurrencës së lirë. Në këtë kuadër, udhëzuesi nuk ka ndonjë detajim sa i përket nivelit të pavarësisë që duhet të ketë ky institucion, të jetë i themeluar nën Kuvend, nën Qeveri apo të jetë i vendosur diku tjetër. Në anën tjetër, udhëzuesi përmend edhe themelimin e një Autoriteti Kombëtar sa i përket monitorimit të ndihmës shtetërore dhe as në këtë rast nuk përmend nivelin e pavarësisë dhe strukturës institucionale në kuadër të së cilës preferohet të vendoset ky institucion. Në kuptim të funksioneve në të dy rastet (në të dy autoritetet), Kosova i ka themeluar të dy autoritetet, Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin për Ndhimën Shtetërore. Struktura institucionale për ndihmën shtetërore ka funksionuar deri në vitin e kaluar në kuadër të AKK-së si Zyrë për Ndhimë Shtetërore kurse me hyrjen në fuqi të Ligjit për Ndhimën Shtetërore, zyra në fjalë dhe personeli i saj kanë kaluar në kuadër të departamentit për ndihmë shtetërore në kuadër të Ministrisë së Financave. Me këtë është përmbushur kërkesa e themelimit të dy autoriteteve të ndara sipas udhëzuesit të BE-së dhe me udhëzues nuk përcaktohet nëse këto autoritete duhet të funksionojnë njëri nën Kuvend (AKK) e tjetri nën Qeveri (Ministri të Financave). Sikur në të gjitha rastet, udhëzuesi dhe dokumentet tjerë referuar të BE-së, nuk kërkojnë nëse një trup/strukturë/institucion duhet të jetë nën Kuvend. Ajo çfarë kërkohet, që në rastin e Kosovës keqkuptohet, është kërkesa për pavarësi funksionale dhe operative dhe me këtë nuk nënkuptohet që institucioni duhet të vendoset nën Kuvendin e Kosovës. Pavarësi në kuptim të institucionit do të thotë e drejta e institucionit të ushtrijë funksionet për çka është krijuar pa ndonjë ndikim, të propozojë dhe shpenzojë buxhetin pa ndikime nga jashtë, të bëjë planin e punës dhe të zbatojë atë pa ndikim, dhe në asnjë rast nuk do të thotë që këto elemente sigurohen me vendosjen e institucionit në kuadër të Kuvendit.

Sa i përket privatizimit dhe në këtë rast Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), kjo çështje në udhëzues është trajtuar nën kapitullin e politikës industriale dhe të ndërmarrësisë<sup>27</sup>. Sipas udhëzuesit,

nuk ka ndonjë kërkesë formale në kuptim të strukturave administrative për të zbatuar këtë kapitull të trupit të ligjeve të BE-së. Megjithatë, udhëzuesi ofron një orientim të strukturave politikbërëse dhe agjencive implementuese në këtë aspekt. Sa i përket politikbërjes, udhëzuesi përcakton Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik si trupi qendror dhe përgjegjës për formulimin dhe koordinimin e politikave por një edhe faktin e ekzistimit në disa shtete edhe të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Në këto raste (rasti edhe i Kosovës) fusha e politikave ekonomike dhe me theks të veçantë të politikave mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është e ndarë në mes të dy ministrive. Në shtetet që hasen shembuj të tillë supozohet për një bashkëpunim shumë të ngushtë në mes të dy ministrive në fjalë. Sa i përket agjencive që duhet të zbatojnë politikat e njërës apo dy Ministrive, udhëzuesi radhitë këto agjenci në nivel qendror: 1) agjencinë e privatizimit, 2) autoritetin e konkurrencës, 3) agjencia për zhvillimin e bizneseve, 4) agjenci përgjegjëse për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, 5) odën ekonomike dhe 6) asociacionin e bizneseve. Për mënyrën e funksionimit dhe pozicionimit të tyre, udhëzuesi nuk jep ndonjë orientim nëse këto duhet të jenë nën Kuvend, Qeveri apo ndonjë element tjetër. Në rastin e Kosovës, Agjencia e Privatizimit është e ndarë dhe e pavarur që funksionon nën Kuvend, po ashtu Autoriteti i Konkurrencës derisa strukturat nën 3 dhe 4 funksionojnë nën MTI vetëm me emra pak më të ndryshëm. Po ashtu, oda ekonomike dhe asociacioni i bizneseve janë struktura të cilat janë funksionale në Kosovë. Nëse kthehemi te pika që paraqet idenë kryesore të punimit, nevojën e ekzistimit dhe funksionimit e raportimit të këtyre shtatë agjencive, në rastin specifik AKP, nuk do të thotë që të funksionojë dhe raportojë në Kuvendin e Kosovës. Nëse i referohemi udhëzuesit, një agjenci e privatizimit do të duhej të funksionoj nën Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe pastaj nën këtë Ministri do të zhvilloheshin politikat për zhvillim ekonomik në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Sa i përket komunikimeve elektronike dhe në këtë rast Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), udhëzuesi e trajton këtë element nën kapitullin e shoqërisë së informacionit dhe medias<sup>28</sup>. Në këtë rast udhëzuesi një pavarësinë e Autoriteteve Rregullative për Komunikime Elektronike nga të cilët kërkohet që të bashkëpunojnë me Organin e Rregullatorëve Evropian për Komunikime Elektronike (ang. BEREC) i cili ndihmon në sigurimin

27 Udhëzuesi i Komisionit Evropian, Politika industriale dhe e ndërmarrësisë, kapitulli 20, f. 81.

28 Udhëzuesi i Komisionit Evropian, Kapitulli 10, faqe 36.

e një konkurrence të hapur dhe një konsistence të rregullimit në tërë hapësirën e BE-së<sup>29</sup>. Nga viti 2009 kur është themeluar BEREC dhe me nisjen e pakos së reformave në telekom, pavarësia e autoriteteve rregullatore vetëm sa është forcuar dhe me këtë gjithnjë është kërkuar që mos të ketë ndërhyrje të politikës në detyrat e përditshme të autoriteteve rregullatore dhe se këto duhet të kenë buxhet të mjaftueshëm dhe staf të kualifikuar për të kryer detyrat e dhëna me ligj dhe për të qenë të aftë në bashkëpunimin me BEREC.

Sa i përket fushës së minierave dhe mineraleve dhe në këtë rast të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), udhëzuesi nuk ofron ndonjë orientim të funksionimit të organeve/strukturave në këtë aspekt. Në anën tjetër, sa i përket politikave dhe strukturave në transportin hekurudhor, në këtë rast të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH), udhëzuesi ka një numër të rekomandimeve në këtë drejtim. Sipas udhëzuesit, duhet të funksionjë një autoritet i ndarë nga institucioni i cili ofron shërbimet e transportit hekurudhor e cili duhet të ketë rolin e licencuesit të ofruesve të shërbimit të transportit<sup>30</sup>. Udhëzuesi njeherë edhe karakterin rregullativ të organit licencues i cili duhet të shërbejë edhe si organ për shqyrtimin e ankesave, tarifave, nivelit dhe strukturës së tarifave, etj. Në anën tjetër, ajo çfarë kërkon udhëzuesi është më tepër ekzistimi i një ndarje të qartë në mes të autoritetit rregullator dhe licencuesit dhe ofruesit të shërbimeve të transportit.

Për më shumë, udhëzuesi nuk thotë që në rast se ofruesi i shërbimeve është ndërmarrje publike nën pronësi qendrore (rastet me Trainkos dhe Infrakos), autoriteti rregullativ dhe licencues duhet të jetë nën Kuvend. Me rëndësi në këtë pikë është që njëri dhe tjetri të jenë të ndarë në kuptimin funksional, të pavarur në marrjen e vendimeve, me buxhet të ndarë dhe po ashtu më organizim të ndarë.

Sa i përket politikave të energjisë dhe në këtë rast funksionimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), udhëzuesi kërkon që shtetet që implementojnë trupin e ligjeve të BE-së duhet të kenë edhe një institucion rregullator i cili është plotësisht i pavarur nga interesat tjerë në fushën e energjisë të cilët në mes tjerash janë përgjegjës për caktimin dhe aprovimin e transmisionit dhe tarifave të distribucionit, monitorimin e planeve për investime të operatorëve të transmisionit dhe elementë të tjerë. Në rastin e strukturave tjera, udhëzuesi përmend edhe nevojën për funksionim të pavarur të operatorit të transmisionit dhe operatorit të distribucionit të energjisë por nuk ofron më tej detaje se në çfarë kuptimi duhet këto të jenë të pavarura. Në rastin e Kosovës, ZRRE është autoriteti rregullator i energjisë i pavarur nga Qeveria dhe operatorët tjerë i cili funksionon nën Kuvendin e Kosovës, KOSTT si operator sistemi dhe transmisioni në formën e ndërmarrjes publike por me vija të llogaridhënies në Kuvend të Kosovës, KEDS si ndërmarrje e privatizuar dhe KEK prap ndërmarrje publike në pronësi qendrore me vija të llogaridhënies në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE).

29 BEREC është një agjenci e BE-së me zyrë në Riga, Letoni: <https://bit.ly/2jjaoDO>

30 Udhëzuesi i Komisionit Evropian, Kapitulli 14.2, faqe 58.

# Analizë e praktikave të vendeve të rajonit mbi funksionimin dhe raportimin e shtatë agjencive

Përveç kërkesave për mënyrën e funksionimit të shtatë agjencive që dalin nga procesi i integritetit të Kosovës në BE, me rëndësi në këtë punim është të analizohen edhe praktikave të vendeve të rajonit në këtë aspekt. Për më shumë, vendet e rajonit, me përjashtim të Bosnje dhe Hercegovinës kanë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE, kanë nënshkruar shumë më herët Marrëveshje të Stabilizimit Asocimit (MSA) dhe me një fjalë janë më afër në procesin e integritetit në BE. Vendet që janë zgjedhur të trajtohen në këtë pjesë të punimit janë Shqipëria, Mali i Zi dhe Kroacia. Kjo e fundit është praktikë interesante për dy arsye: e para, ndan me vendet tjera të rajonit një të kaluar të ngjashme dhe e dyta, është anëtare e BE-së. Kjo pjesë trajton mënyrën apo modelin e funksionimit të shtatë agjencive që janë objekt në këtë punim, d.m.th se si funksionojnë, cili është niveli i pavarësisë, a janë të vendosura nën Kuvend ose Qeveri dhe elementë të tjerë të cilët janë përmendur në punim.



## Shqipëria

Në Shqipëri ekziston po ashtu autoriteti me emër të njëjtë: Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) por që mënyra e funksionimit institucional është më e ndryshme nga ajo e AAC-së në Kosovë. Derisa AAC në Kosovë është i themeluar me Ligjin për aviacionin civil, në Shqipëri AAC është i themeluar me Ligjin për AAC-në, d.m.th me ligj të veçantë<sup>31</sup> dhe jo përmes ligjit sektorial apo të fushës. Megjithatë, kjo përbën pak dallim në krahasim me elementët tjerë. AAC në Shqipëri funksionon nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me status të një institucioni varësie<sup>32</sup> (paralel me agjencinë ekzekutive në kuadër të ministrisë në Kosovë), i përgjigjet Ministrisë për çështjet për çka është AAC përgjegjës sipas ligjit dhe nuk ka ndonjë linjë llogaridhënie direkte me Kuvendin e Shqipërisë<sup>33</sup>. Në Kosovë, AAC është i ndarë nga Qeveria, është i përmendur në Kushtetutë dhe vijë të llogaridhënieve ka edhe Kuvendin, Pastaj, derisa AAC në Kosovë udhëhiqet nga Bordi dhe Drejtori i Përgjithshëm, AAC në Shqipëri udhëhiqet nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv. Mënyra e zgjedhjes së organit kolegjal (bordit apo këshillit drejtues) është e njëjtë: propozohet nga Ministri dhe emërohet nga Qeveria apo Këshilli i Ministrave. Në anën tjetër, derisa drejtori i përgjithshëm propozohet nga Ministri i Infrastrukturës dhe emërohet nga Qeveria (në Kosovë), drejtori ekzekutiv emërohet drejtpërdrejt nga Ministri.<sup>34</sup> Dallimi kryesor dhe cfarë është më me interes në këtë punim është kuadri në të cilin funksionon AAC dhe dallimi këtu është se AAC në Shqipëri llogaritet pjesë e ekzekutivit ngase ka përgjegjësi ekzekutive dhe është institucion varësie në kuadër të Ministrisë, derisa AAC në Kosovë bën pjesë në listën e agjencive të pavarura të cilat thirren në Kushtetutë (si kategori kushtetuese) apo në Nenin 142 të Kushtetutës mbi agjencitë e pavarura.

Në fushën e mbrojtjes së konkurrencës, po ashtu institucioni përgjegjës në Shqipëri për ruajtjen e konkurrencës së lirë është Autoriteti i Konkurrencës (AK) i themeluar me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës<sup>35</sup>. Mënyra e funksionimit apo kuadri insti-

31 Ligj nr. 10 233, datë 11.2.2010 për Autoritetin e Aviacionit Civil: <https://bit.ly/2rl6jmv>

32 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Institucionet e Varësisë: <https://bit.ly/2J0mXlb>

33 Ligj nr. 10 233, datë 11.2.2010, Neni 20, Raportimi nga Autoriteti.

34 Ligj nr. 10 233, datë 11.2.2010, Neni 12, Drejtori Ekzekutiv.

35 Ligj nr. 9121, datë 28.7.2003 për Mbrojtjen e

tucional në të cilin vepron AK në Shqipëri është mjaft i ngjashëm me atë në Kosovë. Autoritet i Konkurrencës është institucioni që njihet nën këtë emër derisa organi vendimmarrës është Komisioni i Konkurrencës. Megjithatë, dallimi në mes të AKK në Kosovë dhe AK në Shqipëri është propozimi i kandidatëve për t'u zgjedhur anëtar të Komisionit: derisa në Kosovë propozimi bëhet nga Qeveria dhe emërimi bëhet në Kuvend, anëtarët e Komisionit të Konkurrencës në Shqipëri propozohen nga tri institucione. Një anëtar propozohet nga Presidenti, dy anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave dhe dy anëtarë tjerë propozohen nga Kuvendi i Shqipërisë<sup>36</sup>. Të propozuarit pastaj zgjedhen ose jo nga Kuvendi i Shqipërisë dhe si organ kolegjal sipas kohës së përcaktuar në ligj (deri më 31 mars) raporton po ashtu në Kuvendin e Shqipërisë. Sa i përket pavarësisë, në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës vetëm thuhet që AK është i pavarur në kryerjen e detyrave të veta të përcaktuara me ligj<sup>37</sup>, por nuk përmenden elemente tjerë si pavarësi organizative, financiare, etj.

Sa i përket fushës së privatizimit dhe institucionit që ushtron këtë funksion, situata është shumë më e ndryshme në Shqipëri. Derisa kjo fushë i është lënë nga fillimi Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), funksioni i privatizimit në Shqipëri ushtrohet nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë<sup>38</sup>. Drejtoria nuk është as institucion varësie por është e organizuar në rang të departamentit në Kosovë, në këtë rast në mesin e shumë drejtorive në këtë nivel në kuadër të Ministrisë. Sidoqoftë, në bazë të procesverbaleve të punës së Komisioneve të Kuvendit<sup>39</sup>, mund të evidentohet se më parë ky funksion është ushtruar nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit (AKP). Në vitin 2006, AKP është shkruar në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike brenda Ministrisë së Financave e cila ka zhvilluar aktivitetin e saj deri më 2013. Nga kjo kohë, privatizimi i pronës publike apo shtetërore është kryer nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nuk ka një uebfaqe të ish-Agjencisë Kombëtare të Privatizimit por prap në bazë të procesverbalit të

Konkurrencës: <https://bit.ly/2rdQEEk>

36 Ligj nr. 9121, datë 28.7.2003, Neni 21.

37 Ligj nr. 9121, datë 28.7.2003, Neni 18.

38 Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike (DDPP): <https://bit.ly/2HNI1rt>

39 Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, procesverbal, datë: 03.02.2015: <https://bit.ly/2jm3nkV>

Komisionit për Ekonominë dhe Financat i Kuvendit të Shqipërisë, nuk flitet për ndonjë agjenci të ndarë nga elzekutivi ose për një agjenci e cila ka funksionuar në kuadër të Kuvendit të Shqipërisë.

Në fushën e komunikimeve elektronike, i njëjti organ rregullator funksionon edhe në Shqipëri, përkatësisht Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)<sup>40</sup> dhe kuadri institucional në të cilin ushtron detyrat AKEP është i njëjtë me ARKEP në Kosovë. AKEP është i ndarë nga ministria, është organ rregullator, i pavarur në marrjen e vendimeve brenda kompetencave të tij, anëtarët zgjedhen nga Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave dhe raporton në Kuvend. Dallimet që mund të hasen në mes të AKEP dhe ARKEP janë sa i përket zgjedhjes së anëtarëve të organit drejtues (apo bordit), kryetarit të organit drejtues dhe raportimit. Sa i përket zgjedhjes së anëtarëve të këshillit drejtues të AKEP, ata propozohen nga Këshilli i Ministrave dhe zgjedhen nga Kuvendi<sup>41</sup> derisa në rastin e ARKEP, anëtarët e bordit propozohen nga Qeveria por me propozim të Ministrit, në këtë rast të Ministrit të Infrastrukturës dhe emërohen në Kuvend. Pastaj, në këtë element, një dallim i vogël ndoshta gjuhësor por që mund të jetë me efekt të madh praktik është që mund të krijohet nga fjala "emërohen nga Kuvendi" rasti i Shqipërisë dhe "zgjedhen nga Kuvendi" në rastin e Kosovës. E para, i bije që të emërohen ashtu siç janë propozuar dhe pa mundësi të ndërrimeve kurse e dyta i bije që të zgjedhen, dmth në mesin e propozimeve nga Këshilli i Ministrave të bëhet një zgjedhje nga ana e Kuvendit të Shqipërisë. Sa i përket dallimeve tjera, kryetari i AKEP në Shqipëri zgjedhet nga Kuvendi në mesin e anëtarëve derisa kryetari i ARKEP në rastin e Kosovës propozohet nga ministri njëri nga anëtarët që propozohen për emërim në Kuvend. Në të dy rastet, organi drejtues (bordi apo këshilli drejtues) përbëhet nga pesë anëtarë dhe kanë të drejtën e rizgjedhjes vetëm edhe njëherë. Elementi i tretë, ai i raportimit, derisa në rastin e ARKEP nuk përmendet të dërgohet një kopje e raportit vjetor edhe tek Ministri, në rastin e AKEP, raporti vjetor dërgohet brenda katër mujorit të parë në Kuvend por edhe një kopje dërgohet për Ministrin<sup>42</sup>. Sa i përket pavarësisë, pothuajse e njëjta fjali përdoret në të dy ligjet, që autoriteti është person juridik dhe në punën dhe marrjen e vendimeve brenda kompetencave të tij është i pavarur.

Në fushën e sektorit minierar, funksionet në këtë fushë ushtrohen nga struktura të ndryshme institucionale në Shqipëri në krahasim me Kosovë. Në Shqipëri kjo fushë është brenda një Ministrie, Min-

40 Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë: <https://bit.ly/2waqYGy>

41 Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, Neni 114.

42 Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, Neni 9.

istrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e cila harton politikat edhe për sektorin mineral dhe pastaj Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)<sup>43</sup> me status të institucionit të varësisë në kuadër të së njëjtës Ministri, zbaton politikat në sektorin mineral dhe në përputhje me Ligjin për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë<sup>44</sup>. AKBN është e organizuar në katër drejtori: drejtoria për energjitë e rinovueshme, drejtoria për hidrokarburet, drejtoria për minerat dhe drejtoria e hidroenergjetikës<sup>45</sup>. Pra, derisa në Shqipëri sektori mineral ushtrohet brenda një Ministrie (drejtorisë dhe institucionit të varësisë), në Kosovë kjo fushë ushtrohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (departamenti i minierave) dhe Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) i cili është agjenci e pavarur e themeluar në bazë të Nenit 142 të Kushtetutës mbi agjencitë e pavarura. Vlenë të përmendet se këtu nuk është fjala edhe për shërbimin gjeologjik i cili në të dy vendet është i organizuar si agjenci (Kosovë) dhe institucion varësie (Shqipëri) vetëm se në përbërje të Ministrive të ndryshme, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në Shqipëri dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në Kosovë.

Sa i përket sektorit hekurudhor, situata duket më pak e definuar në kuptim të strukturave institucionale në këtë sektor. Në aspektin e ligjeve, ekziston Kodi Hekurudhor i cili liston një numër të autoriteteve si struktura për t'u themeluar konform ligjit dhe përgjegjës për këto aspekte: rregullimin e sektorit (Autoriteti Rregullator i Hekurudhave), sigurinë (Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore), licencimin (Autoritetin Licencues Hekurudhor) dhe hetimin e aksidenteve (Autoritetin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore)<sup>46</sup>. Kodi përcakton detyrat e autoriteteve dhe tregon një lidhje në mes të ministrit përgjegjës për transportet dhe autoriteteve si subjekte në fushën e sektorit hekurudhor, por nuk ofron detaje se si janë të organizuara këto autoritete. Për më shumë, nuk ka as informacion të plotë në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të parë nëse këto autoritete janë të organizuara si drejtori, institucione të varësisë në kuadër të ministrisë apo

janë të ndara nga Ministria. Megjithatë, në ligj ceket që Ministri përgjegjës për transporte emërohen drejtuesin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor<sup>47</sup> dhe me këtë mund të kuptohet se Autoriteti mund të jetë i organizuar nën Ministri dhe jo i ndarë nga Ministria. Po ashtu, në ligj nuk përmendet ndonjë komunikim i autoritetit me Kuvendin në kuptimin e raportimit të tij në Kuvend.

Në fushën e energjisë, kuadri institucional në nivelin e rregullatorit është gati i njëjtë në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. Në Shqipëri funksionon Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i cili bënë rregullimin e sektorit të energjisë, është i organizuar jashtë Qeverisë, raporton në Kuvend dhe është i themeluar me ligjin sektorial, përkatësisht Ligjin për sektorin e enërgjisë elektrike<sup>48</sup>. Dallimi në mes të ERE dhe ZRRE në Kosovë është mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të bordit. Të katër anëtarët dhe kryetari i bordit i ERE zgjedhen nga një Ekip Përzgjedhës i cili përbëhet nga tre persona: dy përfaqësues të Kuvendit (Kryetari i Komisionit për Ekonomi dhe Financa dhe Kryetari i Komisionit përgjegjës për energjinë) dhe Ministri përgjegjës për energjinë. Në rastin e ZRRE, konkursi është i hapur sikurse në Shqipëri por që procesi në vend të Ekipit Përzgjedhës, zhvillohet brenda Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe në ligj nuk ceket se kush e përbën komisionin përzgjedhës. Sa i përket raportimit, ERE raporton në Kuvendin e Shqipërisë brenda tre muajve të parë të vitit aktual i cili përfshinë raportimin për vitin paraprak. Bordet në të dy vendet përbëhen nga pesë anëtarë duke përfshirë Kryetarin e bordit, kanë mandat pesë vjeçar dhe me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat. Sa i përket vlerësimit të përputhshmërisë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, organizimi, kompetencat dhe pavarësia e ERA janë në përputhje me trupin e ligjeve të BE-së, megjithatë, në këtë vlerësim ceket që rotacioni në mes të anëtarëve të bordit nuk është i përcaktuar me ligj edhe aplikohet dhe funksionon në praktikë<sup>49</sup>.

43 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore: <https://bit.ly/2HRaZXc>

44 Ligji nr. 10/2010, datë 15.7.2010 për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë: <https://bit.ly/2rgLmsC>

45 Agjencia Kombëtare e Burimeve Njerëzore (AKBN), drejtoritë: <http://www.akbn.gov.al/>

46 Ligji nr. 142/2016 Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë: <https://bit.ly/2rgBO0H>

47 Ligji nr. 142/2016 Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë. Neni 55.

48 Ligji nr. 43/2015 për Sektorin e Energjisë Elektrike: <https://bit.ly/2Kwc1tu>

49 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Përputhshmëria, Autoritetit rregullator: <https://bit.ly/213zCjv>



## Mali i Zi

Në fushën e transportit ekzistojnë disa institucione shtetërore të cilat ushtrojnë funksione të ndryshme por me rëndësi për temën janë: Ministria e Transportit dhe Çështjeve Detare dhe Agjencia e Aviacionit Civil (AAC). AAC është themeluar me Ligjin për Transportin Ajror<sup>50</sup>. Politikat në aviacion civil ushtrohen nga ministria derisa agjencia si pjesë e ministrisë ka kompetencat në zbatim të ligjit dhe politikave tjera që i harton ministria. Relacioni në mes të ministrisë dhe agjencisë është në këtë kuptim: agjencia është e pavarur në ushtrimin e kompetencave sipas ligjit por anëtarët e Këshillit si organ menaxherial i AAC-së zgjedhen dhe mbahen përgjegjës nga Qeveria. Këshilli zgjedhë dhe shkarkon Drejtorin me pëlqimin e Ministrit të Transportit dhe Çështjeve Detare. Në bazë të kësaj, mund të thuhet që AAC është institucion ekzekutiv në kuadër të Qeverisë sepse zgjedhet dhe raporton në Qeveri<sup>51</sup>.

Në fushën e mbrojtjes së konkurrencës, Agjencia për Mbrojtjen e Konkurrencës (AMK) është institucioni përgjegjës për të siguruar një konkurrencë të lirë në treg. AMK është themeluar me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës<sup>52</sup> në Mal të Zi dhe ka dy organe: këshillin dhe drejtorin. AMK është agjenci në kuadër të Qeverisë sepse organet e agjencisë zgjedhen nga Qeveria dhe atë në këtë mënyrë: këshilli përbëhet nga Kryetari dhe dy anëtarë dhe Qeveria zgjedhë Kryetarin dhe njërin anëtar me propozim të Ministrisë derisa anëtarin tjetër e zgjedhë prap Qeveria por me propozim të organit të administratës shtetërore kompetent për ndihmën shtetërore. Para plotësimit ndryshimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, AMK ka raportuar vetëm në Qeveri derisa tani AMK raporton në Qeveri dhe Parlamentin e Malit të Zi<sup>53</sup>. Organi i dytë i AMK, drejtori zgjedhet nga Qeveria sipas propozimit të Qeverisë për një mandat katër vjeçar. Drejtori ka një zëvendës dhe dy asistent drejtor, njëri për mbrojtjen e konkurrencës dhe tjetri për ndihmën shtetërore të cilët po ashtu zgjedhen nga Qeveria.

Sa i përket fushës së privatizimit, Këshilli për Privatizim dhe Projekte Kapitale<sup>54</sup> është institucioni përgjegjës për menaxhimin dhe njëkohësisht mbikëqyrjen e procesit të privatizimit në Mal të Zi. Këshilli është institucion qeveritar dhe mandati i tij buron nga Ligji për Privatizimin i cili është nxjerrë në vitin 1996 dhe plotësuar në vitin 1999, 2000 dhe 2004. Procesi i privatizimit organizohet nga Këshilli i cili bazuar në Ligjin për privatizimin harton plane vjetore për privatizim të cilat i propozon për miratim në Qeveri. Planet vjetore janë të gjitha publike dhe plani i privatizimit për vitin 2018 është miratuar nga Këshilli dhe dërguar për miratim në Qeveri në shkurt të 2018.<sup>55</sup> Këshilli përbëhet prej 17 anëtarëve, kryesohet nga Kryeministri i cili është edhe Kryetari i Këshillit, disa ministrave, odës ekonomike, dhe federatës së unionit tregtar.<sup>56</sup>

Në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, autoriteti rregullativ është Agjencia për Komunikime Elektronike dhe Shërbime Postare (AKESHP)<sup>57</sup> e cila është e themeluar me Ligjin për komunikime elektronike në Mal të Zi. AKESHP përveq ligjit ka edhe një statut i cili përcakton rregullat e funksionimit të tij, është i miratuar nga Këshilli i agjencisë dhe Parlamenti në Mal të Zi. Dy organet e agjencisë janë: këshilli dhe drejtori ekzekutiv. Këshilli është organi më i lartë vendimmarrës dhe përbëhet prej pesë anëtarëve përfshirë edhe kryetarin të cilët zgjedhen nga Parlamenti në bazë të konkursit të hapur. Drejtori ekzekutiv po ashtu zgjedhet me konkurs të hapur por nga Këshilli i agjencisë. Këshilli raporton në Parlament përmes raportit mbi aktivitetet dhe raportit financiar të cilët miratohen në Parlament. Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës para Këshillit<sup>58</sup>.

Sa i përket sektorit të minierave dhe mineraleve, ekziston Ligji për miniera<sup>59</sup> por nuk specifikon institucionin në kuptimin e agjencisë që ushtron aktivitetet sa i përket rregullimit të sektorit minerar dhe lëshimit të lejeve dhe licencave konform këtij as-

50 Ligji nr. 01-676/2, datë 4.6.2012: <https://bit.ly/2HLuXH9>

51 Agjencia e Aviacionit Civil në Mal të Zi: <https://bit.ly/2HNzEA8>

52 Ligji nr. 44/12 për mbrojtjen e konkurrencës: <https://bit.ly/2HZ3Vb9>

53 Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës: <https://bit.ly/2FS5k10>

54 Këshilli për Privatizim dhe Projekte Kapitale: <https://bit.ly/2rqiv58>

55 Takim i Këshillit për Privatizimin dhe Projektet Kapitale miraton Planin e privatizimit për 2018: <https://bit.ly/2lr4P3w>

56 Mandati i Këshillit, struktura dhe anëtarët planet vjetore të privatizimit janë të qas'shme përmes linkut: <https://bit.ly/2lhvP5L>

57 Agency for Electronic Communications and Postal Services: <http://www.ekip.me/eng/>

58 Ligji nr. 01-1452/2, 2 gusht 2013: <https://bit.ly/2K200cr>

59 Ligji nr. 01-1850/2 për Miniera

pekti. Në ligjin në fjalë vetëm ceket fjala "autoritet kompetent" në këtë fushë mirëpo nuk tregohet se kush është autoriteti përkatës. Në anën tjetër, nga ligji kuptohet se nuk është fjala për ndonjë autoritet/institucion në varësi të Parlamentit sepse në çështjen e ankesave ndaj vendimeve të autoritetit kompetent, ceket që aneksa mund të ushtrohet ndaj Ministrisë e cila në fushë të punës ka edhe sektorin minierar. Pastaj, në bazë të organizimit të Ministrisë së Ekonomisë<sup>60</sup> vërehet se sektori minierar është pjesë e portfolios së kësaj ministrie dhe me këtë mund të dëshmohej se nuk kemi të bëjmë me ndonjë agjenci qoftë në varësi të Parlamentit apo edhe të Qeverisë.

Në sektorin e trafikut hekurudhor, Ligji për hekurudha nuk përcakton me emër ndonjë autoritet dhe përgjegjësitë e tij në këtë sektor, përveç që përmend prap fjalën "autoriteti kompetent". Megjithatë, ligji në fjalë përcakton që inspektimin dhe legjisllacionin sekondar që del nga ky ligj do të ushtrohet nga ministria përkatëse për çështje të transportit. Në bazë të ndarjes së dikasterëve ministrore, vërehet se Ministria e Transportit dhe Çështjeve Detare është ministria e cila mbulon sektorin e transportit përfshirë atë hekurudhor. Për transportin hekurudhor, në kuadër të Ministrisë funksionon Drejtorati për Hekurudha<sup>61</sup> përgjegjës për investimet dhe mirëmbajtjen, zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës hekurudhore, aktiviteteve rregullatore dhe për sigurinë në hekurudha. Drejtorati udhëhiqet nga drejtori i cili emërohet nga Qeveria me propozim të Ministrit të Transportit dhe përbëhet nga tri departamente të cilat mbulojnë fushat për të cilat është përgjegjës Drejtorati.<sup>62</sup>

Në fushën e rregullatorit të energjisë, Agjencia Rregullatore e Energjisë (ARE)<sup>63</sup> është institucioni përgjegjës për këtë funksion. Dy organet e ARE janë: bordi dhe drejtori ekzekutiv. Bordi zgjedhet nga Parlamenti bazuar në një propozim të Qeverisë mirëpo i paraprirë nga një konkurs i hapur i cili shpallet nga ARE bazuar mbi statutin për funksionimin e saj. Po ashtu, drejtori ekzekutiv zgjedhet përmes konkursit të hapur nga ARE me mandat katër vjeçar. Anëtarët e bordit kanë mandat pesë vjeçar, nuk mund të zgjedhen më shumë se edhe një herë.<sup>64</sup> Sa i përket

vlerësimit të përputhshmërisë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, vlerësohet se organizimi, kompetencat janë në përputhje me trupin e ligjeve të BE-së me përjashtim të dy ngecje: e para, menaxhmenti nuk është tërësisht i lirë për të vendosur mbi organizimin e brendshëm të rregullatorit pasi që statuti i rregullatorit kërkon miratimin në Qeveri, dhe e dyta, e drejta e ARE për të shqiptuar dënime nuk i takon vet autoritetit por gjykatës kompetente. Edhe pse kjo nuk do të thotë që është në kundërshtim me trupin e ligjeve të BE-së, këto dy elemente e ndikojnë efektivitetin e punës së ARE-s.<sup>65</sup>

## Kroacia

Në fushën e aviacionit civil, Qeveria ka themeluar Agjencinë për Aviacion Civil (AAC)<sup>66</sup> përmes Ligjit për Trafikun Ajror<sup>67</sup>. AAC është agjenci qeveritare, e pavarur në punën dhe në marrjen e vendimeve dhe raporton në Qeveri me anë të raporteve vjetore të punës. Aktivitetet e AAC-së bien nën kompetencën e Ministrisë për Çështje Detare, Trafikun dhe Infrastrukturs. Organet e agjencisë janë: bordi i cili përbëhet nga pesë anëtarë të cilët emërohen nga Qeveria sipas propozimit të ministrit përkatës dhe drejtori i cili zgjedhet nga bordi përmes konkursit por emërohet me pëlqimin e Qeverisë. AAC nuk ka linja të llogaridhënies ndaj Parlamentit në Kroaci.

Sa i përket institucionit për mbrojtjen e konkurrencës, Agjencia Kroate e Konkurrencës (AKK)<sup>68</sup> është institucioni përgjegjës në këtë aspekt. AKK është themeluar me Ligjin për konkurrencën dhe është përgjegjëse ndaj Parlamentit. AKK menaxhohet prej Këshillit të Konkurrencës i cili përbëhet prej pesë anëtarëve të emëruar nga Parlamenti sipas propozimit të Qeverisë. Mandati i anëtarëve është pesë vjeçar me mundësi të ri-zgjedhjes edhe njëherë<sup>69</sup>. Në fushën e privatizimit, në Kroaci ky proces ka nisur në vitin 1990/91 dhe meqenëse ligjet të cilat janë nxjerrë në atë kohë janë në gjuhën kroate dhe vështirë të gjenden në gjuhën angleze, është e pamundur të analizohet këtu struktura institucionale që ka ushtruar funksionet në privatizim.

60 Ministria e Ekonomisë, Minierat dhe Hulumtimi Gjeologjik: <https://bit.ly/2HXtDkP>

61 Drejtorati për Hekurudha: <https://bit.ly/2HXdPxW>

62 Organogrami: <https://bit.ly/2rrK4v3>

63 Agjencia Rregullatore e Energjisë: <https://bit.ly/2115Ek8>

64 Ligji nr. 15-1/15-1/41, 29 dhjetor 2015:

65 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, përputhshmëria, autoriteti rregullator: <https://bit.ly/2lorbmc>

66 Agjencia e Aviacionit Civil: <https://bit.ly/2K7aA3l>

67 Ligji nr. 71-05-03/1-14-2 për Trafikun Ajror: <https://bit.ly/2rwEFCb>

68 Agjencia Kroate e Konkurrencës: <http://www.aztn.hr/en/>

69 Ligji nr. 71-05-03/1-09-2 mbi Konkurrencën: <https://bit.ly/2wr5DRs>

Sipas një raporti mbi privatizimin në Kroaci, procesi realisht kishte filluar në vitin 1991 me miratimin e këtyre ligjeve: Ligjit për Agjencinë për Ristrukturim dhe Zhvillim, Ligjit për Fondin për Zhvillim dhe Ligjit për Transformimin e Ndërmarrjeve Shoqërore. Në 2002, Agjencia dhe Fondi ishin shkrië në një institucion duke krijuar Fondin për Privatizim<sup>70</sup>.

Në fushën e komunikimeve elektronike, në bazë të Ligjit për komunikime elektronike<sup>71</sup>, Agjencia për Komunikime Elektronike dhe Postare (AKEP) është agjencia rregullatore në këtë fushë e themeluar nga Parlamenti dhe Qeveria e Kroacisë. Mirëpo, me plotësim ndryshimin e këtij ligj dhe ligjit për rregullimin e tregut të shërbimeve hekurudhore në vitin 2014, është krijuar një agjenci e vetme rregullatore dhe realisht të dy rregullatorët, Agjencia rregullatore për komunikimeve elektronike dhe postare dhe Agjencia rregullatore për tregun e shërbimeve hekurudhore janë shkrië në Autoritetin Rregullator për Industrinë e Rrjetizimit (Regulatory Authority for Network Industries)<sup>72</sup>. Pas bashkimit të rregullatorëve në një të vetëm është vendosur që rregullatori i ri i përbashkët do të mbajë shkurtesën e emrit të ish-rregullatorit për komunikime elektronike për shkak që të jetë më lehtë i njohur për publikun. Shkurtesa e emrit të rregullatorit për komunikime elektronike ka qenë në gjuhën kroate HAKOM dhe me këtë shkurtesë tani identifikohet në publik rregullatori i përbashkët për të dy sektorët. Autoriteti drejtohet nga Këshilli i cili përbëhet nga pesë anëtarë të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Parlamenti pas propozimit të Qeverisë. Këshilli raporton përmes raportit vjetor me shkrim në Parlament dhe në Qeveri.

Sa i përket sektorit të minierave dhe mineraleve, në bazë të Ligjit për miniera (Minig Act)<sup>73</sup>, institucionet kompetente në këtë fushë janë departamentet e minierave në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, Ndërmarrjes dhe Punës<sup>74</sup>. Sipas ligjit në fjalë (neni 149), përveq hartimit të politikave në sektorin e minierave në formën e Strategjisë për Menaxhimin Materialeve Minerale e cila miratohet nga Qeveria dhe Parlamenti, Ministria dhe departamen-

ti përkatës për miniera është përgjegjëse edhe për trajtimin e kërkesave për t'u pajisur me licencë dhe leje për eksploatimin e mineraleve. E tërë procedura prej kushteve që duhet të respektohen deri te marrja e licencës është e rregulluar me vendim apo urdhëresë (ordinance) e lëshuar nga Ministri që në portfolio të punëve ka edhe sektorin e minierave.

Në fushën e sektorit të energjisë, Agjencia Rregullatore e Energjisë (ARE)<sup>75</sup> është institucioni përkatës rregullator në fushën e energjisë. ARE është themeluar me Ligjin për rregullimin e aktiviteteve në fushën e energjisë<sup>76</sup> e cila organizimin e brendshëm, mbikëqyrjen, fushëveprimtarinë, vendimmarrjes dhe elementë të tjerë i ka të përcaktuara me Statut i cili hartohet nga Bordi menaxhues dhe miratohet nga Qeveria. Sipas nenit 8 të Ligjit në fjalë, themelus i ARE është Qeveria mirëpo raporton në Parlament. Bordi përbëhet prej shtatë anëtarëve të cilët zgjedhen nga Parlamenti të propozuar nga Qeveria por bazuar në një listë të kandidatëve potencial të cilët janë rekrutuar në bazë të një konkursi publik. Mandati i tyre është shtatë vjeçar me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe njëherë.

70 Bendekovic, J., Privatisation in Croatia, f.55-60.

71 Ligji nr. 71-05-03/1-08-2, për Komunikime Elektronike: <https://bit.ly/2KJbl41>

72 Autoriteti Rregullator për Industrinë e Rrjetizimit: <https://bit.ly/2KNhsV4>

73 Ligji nr. 71-05-03/1-13-2 për Miniera: <https://bit.ly/2jNcoFk>

74 Ministria e Ekonomisë, Ndërmarrjes dhe Punës: <https://bit.ly/2laxfLZ>

75 Agjencia Rregullatore e Energjisë: <https://bit.ly/2K9a7Oo>

76 Gazeta Zyrtare nr. 120/12, Ligji për rregullimin e aktiviteteve në fushën e energjisë (i qas' shëm online është vetëm version i vitit 2007 por që tani nuk është më në fuqi pas plotësim ndryshimit të ligjit në vitin 2012).

# Parimet e OBEZH-it për qeverisjen e rregullatorëve

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH) ka publikuar gjatë viteve disa manuale që flasin për parimet dhe praktikatat më të mira sa i përket qeverisjes së rregullatorëve. Në këtë funksion, OBEZH në vitin 2014 ka publikuar manualin "Qeverisja e Rregullatorëve – parimet dhe praktikatat më të mira"<sup>77</sup> në të cilën diskuton elementet e pavarësisë së rregullatorëve dhe në përgjithësi cilët janë parimet për një funksionim të mirëfillt të rregullatorëve. Në fakt, tërë manuali është i shkruar rreth shtatë parimeve që duhet të ndjekin rreth qeverisjes së rregullatorëve: 1) të definohet saktë roli i rregullatorit, 2) të parandalohet ndikimi politik dhe ruajta e besimit në publik rreth pavarësisë së rregullatorit, 3) cilat janë strukturat e qeverisjes tek rregullatorët e pavarur, 4) llogarodhënia dhe transparencja, 5) bashkëpunimi me entitetet dhe palët tjera me interes, 6) financimi dhe 7) vlerësimi i performancës. Qëllimi në këtë pjesë nuk është për të dhënë vlerësime se sa rregullatorët në Kosovë qeverisen konform këtyre parimeve, por vetëm të ofrohen këto parime dhe të cilat do të mund të shërbenin si kritere të mira kundrejt të cilave mund të matet e tërë qeverisja e rregullatorëve në një punim të ardhshëm.

Megjithatë, në këtë pjesë është me rëndësi të cekin disa elemente: të kuptuarit e pavarësisë dhe format institucionale të rregullatorëve, nëse rregullatorët janë të përfshirë në formulimin e politikave dhe modelet apo rastet kur dy e më shumë rregullator që mbulojnë disa sektorë shkrihen në një rregullator të vetëm e që mund të quhet si rregullator shumë sektorësh (mult-sector or multi-purpose regulators). Lidhur me pavarësinë institucionale, duhet të bëhet e qartë që pavarësia nuk garantohet vetëm me faktin e lënies së rregullatorit nën Parlament, apo që një rregullator nuk është i pavarur nëse është pjesë e Qeverisë. Manuali në fjalë shpjegon që rregullatori mund të jetë edhe një njësi në kuadër të ministrisë ose një entitet i ndarë nga Qeveria<sup>78</sup>. Sa i përket formulimit të politikave, manuali thekson që formulimi i politikave në parim është në kompetencë të Qeverisë e cila përcakton objektivat, prioritetet

dhe qasjen përmes legjislacionit të cilin e propozon për miratim në parlament.<sup>79</sup> Në lidhje me pikën e tretë, atë të funksionimit të rregullatorëve që mbulojnë disa fusha apo sektore, siç është dhënë rasti më herët në Kroaci ku rregullatori për komunikime elektronike dhe postare dhe ai për hekurudha janë shkriur në një, është një trend në rritje i shkrires së disa rregullatorëve në një. Për këtë arsye, por që më vonë mund të konsiderohet edhe për Kosovë, punimi ofron më poshtë rastin e Holandës kur tre rregullatorë janë shkriur në një<sup>80</sup>.

## Rregullatorët shumë-sektorësh: rasti i Holandës

Holanda përfaqëson një prej vendeve ku disa rregullator, në këtë rast tre, janë bërë bashkë ose janë shkriur për të krijuar një rregullator të vetëm. Me 1 Prill 2013, Autoriteti për Konsumator, Autoriteti i Konkurrencës dhe Autoriteti për Telekomikacion dhe Shërbime Postare janë shkriur në një autoritet, Autoritetin për Konsumator dhe Tregje (Authority for Consumers and Markets-ACM)<sup>81</sup>. Autoriteti është përgjegjës për rregullimin ekonomik të gjashtë fushave apo sektorëve: ujit, energjisë, telekomunikacionit, transportit, konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Autoriteti ka si organe: bordin, shtatë departamente sipas sektorëve që mbulon autoriteti, të udhëhequra nga drejtorë, zyrën për komunikim dhe politika dhe zyrën e ekonomistit kryesor (chief economist). Secili departament ka ekipet të cilat janë përgjegjës për një numër të detyrave sipas fushave që mbulojnë ato: departamenti i konsumatorit, departamenti i energjisë, departamenti i telekomunikacioneve, transportit dhe shërbimeve postare, departamenti i konkurrencës, departamenti ligjor, departamenti për shërbime korporative dhe departamenti i kujdesit shëndetësor<sup>82</sup>.

77 OBEZH (2014), "Qeverisja e Rregullatorëve – parimet dhe praktikatat më të mira": <https://bit.ly/2lts3Gp>

78 Po aty, f. 18

79 Po aty, f. 37

80 Po aty, f. 36

81 Ligji për themelimin e Autoritetit për Konsumator dhe Tregje: <https://bit.ly/2lSomki>

82 Struktura organizative: <https://bit.ly/2luRV4M>

# Përfundime dhe rekomandime

Funksionet bazë për të cilat janë themeluar këto agjenci duhet të ushtrohen, megjithatë, mënyra se si funksionojnë dhe raportojnë ato, duhet të ndryshojë. Për shembull, AAC duhet të funksionojë si autoriteti kompetent në fushën e aviacionit civil, por mënyra e funksionimit dhe raportimit të tij duhet të ndryshojë. Pastaj, procesi i privatizimit apo transformimit të ndërmarrjeve shoqërore duhet të vazhdojë deri në përfundim të privatizimit të të gjitha ndërmarrjeve që janë në regjistër për t'u privatizuar, por mënyra e funksionimit dhe raportimit të saj duhet të ndryshojë. Pastaj, lëshimi i lejeve dhe licencave për miniera dhe minerale duhet të ushtrohet nga një institucion në Kosovë, por kjo nuk do të thotë që ky institucion të jetë i pavarur, jashtë ekzekutivit dhe të raportojë në Kuvend. Po ashtu, funksioni rregullator i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave është i diskutueshëm sidomos në kontekstin e sotshëm në Kosovë sepse infrastruktura hekurudhore dhe shërbimi i transportit hekurudhor janë në pronësi shtetërore, marrin para publike në formë të investimeve, dhe të dy funksionet ushtrohen nga ndërmarrje publike në pronësi qendrore.

Tri nga shtatë agjencitë, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë duhet të funksionojnë të pavarura nga ekzekutivi për shkak të natyrës së punëve tipike rregullatore. Megjithatë, një koordinim i mirë i punëve në mes të rregullatorëve sektorial dhe mbrojtësit të konkurrencës në përgjithësi është i domosdoshëm. Pastaj, në këtë punim janë dhënë dy shembuj të shkrirjes së rregullatorëve në një të tillë: rasti i Kroacisë ku Autoriteti i Hekurudhave dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike janë shkrirë dhe kanë krijuar një autoritet të vetëm dhe rasti i Holandës ku tre rregullator janë shkrirë në një rregullator të vetëm

Bazuar në këto përfundime dhe në elementët dhe shembujt e trajtuar më lartë, ky punim ofron një numër të rekomandimeve për mënyrën e funksionimit dhe raportimit të shtatë agjencive:

Të ndryshohet Ligji nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Nenet që kanë të bëjnë me raportimin e Drejtorit të Përgjithshëm në Kuvend të Kosovës. Target për raportim përfshirë edhe politikat e aviacionit duhet të jetë Ministria e Transportit, në këtë rast Ministri, por kjo nuk do të thotë që Drejtori i Përgjithshëm nuk mund të ftohet në ditën kur të raportojë Ministri;

AAC duhet të trajtohet si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës ashtu sikur Agjencia për Shërbimet e Navigimit Ajror, dhe nuk duhet të konsiderohet agjenci e pavarur nën Kuvendin e Kosovës;

AKK duhet të forcohet në kuptimin funksional dhe të garantohet një pavarësi në përzgjedhje e anëtarëve të komisionit të konkurrencës. Duhet të kthehet përcaktimi i cili ka ekzistuar në ligjin bazik (para plotësimit ndryshimit) që anëtarët e komisionit të konkurrencës të zgjedhen përmes konkursit të hapur;

Ligji nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës duhet të ndryshohet për të akomoduar rekomandimin si më sipër por edhe të përcaktojë se si propozohen kandidatët nga Qeveria për anëtar të komisionit të konkurrencës. Duhet të specifikohet se kush e përbën komisionin përzgjedhës, në bazë të cilave kritere përtej kushteve të përcaktuara në ligj përzgjedhën kandidatët, si të sigurohet që kandidatët janë të pavarur politikisht, etj. Po ashtu, duhet të konsiderohet fakti që anëtarët mos të propozohen vetëm nga Qeveria, por të pesë anëtarët të propozohen nga dy ose tri institucione (psh. Presidenti, Kuvendi);

Agjencisë Kosovare të Privatizimit duhet t'i caktohet kohëzgjatja e mandatit varësisht nga numri i ndërmarrjeve dhe aseteve që pritet të privatizohen dhe pas asaj kohe AKP do të duhej të shuhej;

Ligji nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike duhet të plotësohet sa i përket propozimit të anëtarëve të bordit dhe emërimit në Kuvend. Meqenëse ARKEP është i pavarur dhe nën Kuvendin e Kosovës, duhet të sigurohet se edhe përzgjedhja e anëtarëve është e pavarur. Në këtë mënyrë duhet të hiqet fjala "me rekomandim të Ministrisë" dhe të përcaktohen rregulla për përzgjedhjen e tyre, shpalljen e konkursit publik, kush e përbën komisionin përzgjedhës e deri te propozimi nga ana e Qeverisë;

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nuk duhet të jetë nën Kuvend e Kosovës dhe të raportojë në Kuvend për shkak se natyra e punëve të KP-MM-së është e natyrës ekzekutive dhe struktura të tilla edhe në vendet tjera funksionojnë nën Qeveri. KPMM duhet të transformohet si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik;


Ligji nr. 04/L-063 për hekurudhat duhet të plotësohet, nënë që kanë të bëjnë me statusin e bordit dhe faktit që anëtari i pestë i bordit është drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave por në të njëjten kohë është shërbyes civil. Duhet të definohet statusi i bordit, anëtarët dhe fakti që drejtori i përgjithshëm (apo kryeshefi ekzekutiv i ARH-së) mund të marrë pjesë në mbledhje të bordit por nuk mund të jetë anëtar i pestë i bordit por me status të shërbyesit civil;

Ligji nr. 05/L-084 për zyrën e rregullatorit të energjisë duhet të plotësohet tek pjesa e përzgjedhjes së anëtarëve të bordit. Pas konkursit publik që shpallet nga MZHE, duhet të përcaktohet se kush e përbën komisionin vlerësues për përzgjedhjen e kandidatëve për emërim në Kuvend. Çështja e përzgjedhjes nuk duhet të lihet vetëm në dorën e Ministrisë, por të disa institucioneve të cilat mund të garantojnë një objektivitet dhe ndjekje të kriterit të profesionalizimit në përzgjedhjen e anëtarëve të bordit;


Rregullorja e punës së Kuvendit që tani është në fazën e plotësimit/ndryshimit, duhet të ketë një pjesë që përcakton të paktën dy elemente: e para, si emërohen kandidatët e propozuar nga Qeveria apo ata të cilët janë në listën e ngushtë përmes konkursit të hapur në Kuvend dhe presin miratimin në seancë, dhe e dyta, si duhet të veprohet nëse raporti i një agjencie nuk miratohet në seancë. Tek elementi i parë, duhet të përcaktohet që nëse kandidatët e propozuar të Qeverisë nuk marrin votat e mjaftueshme të deputetëve për t'u zgjedhur, procesi kthehet në fillim dhe nuk përsëriten të njëjtit emra deri në zgjedhjen e tyre;

# Shtojcë

## Situata Aktuale



## Situata e Propozuar









Katalogimi në botim - **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

33(496.51)(047)

Rishikim i funksioneve të agjencive : propozime mbi mënyrën e funksionimit dhe raportimit të agjencive që raportojnë në komisionin për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal / përgatitur nga Visar Rushiti. - Prishtinë : Demokraci Plus, 2018. – 44 f. ; 20 cm.

1.Rushiti, Visar

**ISBN 978-9951-758-03-1**





Demokrasi Plus (D+) është organizatë jo qeveritare që bashkon persona që besojnë fuqishëm në vlera demokratike dhe në një Kosovë me demokraci të mirëfilltë. Qëllimi kryesor i D+ është të nxisë vlera dhe praktika demokratike, si dhe politika që stimulojnë aktivizmin qytetarë.

Në kuadër të D+ funksionojnë tri programe kryesore: Programi për Qeverisje të Mirë, Programi për Sundim të Ligjit, dhe Programi për Zgjedhje dhe Parti Politike. D+ punon që të angazhojë institucionet qeveritare, qytetarët dhe mediat në përmirësimin e qeverisjes, avancim të politikave publike dhe fuqizimin e sundimit të ligjit.

Organizata jonë përqendrohet në përdorimin e teknologjisë informative për qëllimet e lartëshënuara, dhe si rezultat ka iniciuar platformat online [ndreqe.com](http://ndreqe.com) dhe [qeverisjatani.info](http://qeverisjatani.info) të cilat ofrojnë hapësirë për pjesëmarrje qytetare në vendimarrje dhe llogaridhënie të institucioneve qeveritare. Për më tepër, D+ është anëtare ProOpen, koalicioni i OJQ-ve, që ka për qëllim ngritjen e transparencës në prokurim publik dhe parandalimin e keqpërdorimit të parasë publike.

[www.dplus-ks.org](http://www.dplus-ks.org)

ISBN 978-9951-758-03-1



**DEMOCRACY PLUS**

Përkrahur nga:

